


RAPORT

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTIT



“PROJEKT IDE, PROJEKT ZBATIM DHE SUPERVIZIM PËR RIGJENERIM TË INTEGRUAR URBAN – BASHKIA PËRMET”

(Njësia Administrative – Përmet; Bashkia - Përmet; Qarku- Gjirokastrër)

Kategoria (Sipas Shtojcës II të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011):

10. Prodhime infrastrukturore.

a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.

Zhvilluesi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Pergatiti: Dr. Gazmend Zeneli

Licence No. LN-9639-05-2015

“Shërbime Ekspertize dhe/ose Profesionale lidhur me Ndikimin në Mjedis”.

QERSHOR 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|------|--|----|
| I. | QËLLIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS..... | 6 |
| II. | LEGJISLACIONI DHE PROÇEDURAT MBROJTËSE TË MJEDISIT | 8 |
| | 2.1. LEGJISLACIONI MJEDISOR..... | 8 |
| | 2.2. LEGJISLACIONI PER MENAXHIMIN E MBETJEVE | 15 |
| | 2.3. LEGJISLACIONI PER PLANIFIKIMIN TERRITORIAL, TRASHEGIMINE KULTURORE DHE GJETJET..... | 17 |
| III. | PERSHKRIMI I MJEDISIT NE ZONEN E PROJEKTIT | 19 |
| | 3.1. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE ZONES..... | 19 |
| | 3.1.1. Habitatet Natyror me Interes Komunitar | 19 |
| | 3.1.2. Zonat e Mbrojtura..... | 21 |
| | 3.1.3. Flora..... | 23 |
| | 3.2. MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK | 31 |
| | 3.2.1. Popullsia..... | 31 |
| | 3.2.2. Zhvillimi ekonomik dhe Punesimi | 32 |
| | 3.3. TRASHEGIMIA HISTORIKE DHE KULTURORE | 33 |
| | 3.4. MJEDISI FIZIK | 39 |
| | 3.4.1. Gjeologjia..... | 39 |
| | 3.4.2. Hidrogeologjia | 41 |
| | 3.4.3. Rrjeti hidrografik | 42 |
| | 3.4.4. Cilesia e Ajrit | 44 |
| | 3.4.5. Zhurmat (Ndotja Akustike)..... | 46 |
| | 3.1.1. Rreziku Sizmik në Përmet | 48 |
| IV. | INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE NË MJEDIS, TË PROJEKTIT | 52 |
| | 4.1. METODOLOGJIA PËR IDENTIFIKIMIN DHE ANALIZËN E NDIKIMEVE | 52 |
| V. | INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE NË MJEDIS | 55 |
| | 5.1. NDIKIMET GJATE FAZES SE ZBATIMIT/NDERTIMIT | 55 |
| | 5.1.1. Ndikimi Social | 55 |

| | | |
|---------|--|-----|
| 5.1.2. | Ndikimet fizike me ndryshime në topografinë lokale | 55 |
| 5.1.3. | Demtimi i Habitave dhe Biodiversitetit | 56 |
| 5.1.4. | Gjenerimi i mbetjeve inerte | 57 |
| 5.1.5. | Ndikimet e mundshme në peisazh dhe anën vizuale..... | 59 |
| 5.1.6. | Presioni mbi burimet (lëndët e para) ekzistuese..... | 66 |
| 5.1.7. | Gjenerimi i Zhurmave dhe Vibrimeve | 66 |
| 5.1.8. | Trafiku dhe emetimet që lidhen me të | 70 |
| 5.1.9. | Siguria dhe shëndeti në punë (OHS)..... | 72 |
| 5.1.10. | Aksidentet | 74 |
| 5.2. | NDIKIMET GJATE FAZES SE FUNKSIONIMIT..... | 75 |
| 5.2.1. | Ndikimet Sociale | 75 |
| 5.2.2. | Përmirësimi i pamjes dhe rritja e vlerës së pasurisë | 75 |
| 5.2.3. | Menaxhimi i papershtatshëm i mbetjeve | 76 |
| 5.2.4. | Gjenerimi i zhurmave..... | 76 |
| 5.3. | KOHËZGJATJA E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE..... | 77 |
| 5.4. | SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMEVE TË MUNDSHME..... | 79 |
| 5.5. | NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDERKUFITAR..... | 80 |
| VI. | INFORMACION MBI SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS | 81 |
| 6.1. | SHKARKIMET E GAZRAVE DHE PLUHURAVE..... | 81 |
| 6.2. | MBETJET E NGURTA..... | 83 |
| 6.3. | SHKARKIMET NË SIPERFAQET UJORE | 87 |
| 6.3.1. | Ujerat sipërfaqësor..... | 87 |
| 6.3.2. | Ujerat nëntokësor | 87 |
| VII. | MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS | 89 |
| 7.1. | MARRËVESHJET INSTITUCIONALE: STRUKTURAT DHE PERGJEGJESITË | 89 |
| 7.2. | MONITORIMI DHE RAPORTIMI | 90 |
| 7.3. | MEKANIZMI I ZGJIDHJES SE ANKESAVE..... | 91 |
| | PERFUNDIME..... | 110 |
| | LITERATURE | 111 |

LISTA E FIGURAVE

| | |
|---|----|
| Figura 1. Zonat e Mbrojtura në Bashkinë Përmet | 22 |
| Figura 2. Zone e Gjëlburuar pranë Gurit të Qytetit..... | 25 |
| Figura 3. Drurë pishë e eger përgjatë kanalit “Perroi i bardhe” | 25 |
| Figura 4. Bimesi barishtore në zonën e projektit..... | 26 |
| Figura 5. Bimesi barishtore në zonën e projektit..... | 26 |
| Figura 6. Dru i ri frasheri..... | 27 |
| Figura 7. Bimesi barishtore | 27 |
| Figura 8. Bimesi që rritet mbi rrenoja..... | 28 |
| Figura 9. Bime kacavjerrëse në shtëpi të vjetra..... | 28 |
| Figura 10. Drurë “Kumbulle e kuqe” përgjatë trotuareve..... | 29 |
| Figura 11. Drurë Selvie në zonën e projektit | 29 |
| Figura 12. Harta e qarkullimit..... | 30 |
| Figura 13. Pozicioni gjeografik i Përmetit dhe densitetet urbane | 32 |
| Figura 14. Ura e Katiut– Benjë | 37 |
| Figura 15. Harta Gjeologjike e Bashkisë Përmet | 40 |
| Figura 16. Harta Hidrogjeologjike e Bashkisë Përmet..... | 42 |
| Figura 17. Nivelet e zhurmës të dëmshme për shëndetin njerëzor | 47 |
| Figura 18. UNI-T UT353BT Sound Level Meter 30-130dB Decibel..... | 48 |
| Figura 19. Harta e shpejtimit spektral SA (0.2) me shuarje 5% | 50 |
| Figura 20. Plani i përgjithshëm i Gjëlburimit për nën-projektin: Rehabilitimi i kanalit “Perroi i bardhe” | 62 |
| Figura 21. Qyteti Modern: Plani i Gjëlburimit – rruga “Elena Gjika” | 63 |
| Figura 22. Qyteti Modern: Plani i Gjëlburimit – rruga “Meleq Gosnishti” | 64 |
| Figura 23. Qyteti Modern: Plani i Gjëlburimit – rruga “Sami Frasheri” | 65 |
| Figura 24. Tabela sinjalizuese për punime ndërtimi..... | 73 |
| Figura 25. Mekanizmi i menaxhimit/zgjidhjes së ankesave..... | 93 |

LISTA E TABELAVE

| | |
|--|----|
| Tabela 1. Vlerat limite te ndoteseve te ajrit bazuar ne shendetin human.... | 10 |
| Tabela 2. Vlerat e synuara (target) te ndoteseve te ajrit | 11 |
| Tabela 3. Nivelet kritike per mbrojtjen e vegjetacionit | 12 |
| Tabela 4. Sasia e CO ₂ të emetuar për çdo njësi administrative në Bashkinë Përmet | 45 |
| Tabela 5. Vlerat e rrezikut sizmik (PGA dhe SA (g)) për Bashkinë Përmet . . | 51 |
| Tabela 6. Klasifikimi i vleresimit te ndikimeve ne mjedis..... | 53 |
| Tabela 7. Percaktimi i rendesise se ndikimit | 54 |
| Tabela 8: Druret eksistues, druret qe do te zhvendosen dhe ato qe do te mbillen | 60 |
| Tabela 9. Nivelet e zhurmës të emetuara nga makineritë më të përdorshme në ndërtim [ne dB(A)] | 66 |
| Tabela 10. Aktivitetet e ndertimit dhe ndikimi i vibrimeve..... | 68 |
| Tabela 11. Nivelet e parashikuara te vibrimit te pajisjeve te ndertimit | 69 |
| Tabela 12. Faktorët e emetimit së makinerive të ndërtimit në cikle të ndryshme pune..... | 70 |
| Tabela 13. Standartet e cilesise se ajrit dhe shkarkimet ndotese ne mjedis | 72 |
| Tabela 14. Normat e shkarkimeve ne ajer nga kamionet 7.5-16 ton. | 82 |
| Tabela 15. Rrymat e mbetjeve dhe Kodi sipas EWC per kategorine 17..... | 85 |
| Tabela 16. Treguesit e sasisë së mbetjeve të gjeneruara gjatë ndërtimit të strukturave të reja dhe prishjes së objekteve eksistuese (kg/m ²) | 86 |
| Tabela 17. Plani i Monitorimit dhe Menaxhimit të Ndikimit në Mjedis..... | 94 |

I. QËLLIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është hartuar për projektin “Projekt Ide, Projekt Zbatim dhe Supervizim për Rigjenerim të Integruar Urban – Bashkia Përmet”. Zhvilluesi i këtij projekti është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Objektivi kryesor i projektit është të kontribuojë në zbatimin e komponentit 1 të PZHIUT në dy qytete, Berat dhe Përmet, duke zhvilluar Koncepte të Integruara Projekti Urban (KIPU), me fokus në zonat në studim të qyteteve, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve vendas dhe rritjen ekonomike bazuar në zhvillimin e turizmit lokal në zonat urbane. Bashkimi i konsulentëve Atelier 4 (Shqipëri) dhe Keios (Itali) u përzgjedh nga (FSHZH) për të kryer shërbimet e konsulencës.

Në nenin 7 të Ligjit Nr. 10440 date 07.07.2011 "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" është dhënë në menyre të qarte se cilat projekte i nënshtrohen vlerësimit e ndikimit në mjedis, ku thuhet se: *"Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit"*.

Sipas Ligjit të sipërcituar “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, (ndryshuar me Ligjin Nr. 12/2015 për një ndryshim në Ligjin Nr. 10440, Datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”) dhe Vendimit Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" arrijmë në konkluzionin se: aktiviteti që propozohet duhet ti nënshtrohet Procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Shtojca II: Pika 10, germa b - Prodhime infrastrukturore: Projekte për zhvillime urbane duke përfshirë edhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkingjet për makinat).

Struktura dhe përmbajtja e këtij raporti është në përputhje me Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”.

Raporti përmban dy pjesë: Raportin teknik dhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe janë pjesë e dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e lart-përmendur.

Vlerësimi Paraprak i Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në projektin e përgatitur nga studiot projektuese “Atelier 4” (Shqipëri) dhe “Keios” (Itali) që u përzgjodhen nga FSHZH për të kryer shërbimet e konsulencës. Raporti ka për qëllim të japë konsideratat mbi impaktet mjedisore të projektit të propozuar në mënyrë që të orientojë institucionet, apo organet vendim marrëse në dhënien e miratimit të kryerjes së aktivitetit.

Projekt-idea e ndërtimit dhe aktivitetet që do të kryhen në të janë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Përmetit – i cili pritet të miratohet së shpejti nga KRRTRSH.

Raporti synon të identifikojë efektet negative dhe pozitive dhe të propozojë masa lehtësuese duke marrë në konsideratë përdorimin racional të burimeve natyrore dhe koordinimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të zonës me kërkesa të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është:

1. Të identifikojë ndikimet e mundshme mjedisore në zonën në studim gjatë punimeve për rigjenerimin e lagjes së vjetër historike; rehabilitimit të kanalit Përroi i Bardhë; dhe Përmirësimit të sferës publike dhe hapësirave në qytetin modern (faza 1);
2. Të identifikojë ndikimet e mundshme socio-ekonomike në zonën në studim gjatë dhe pas vënies në jetë të projekti;
3. Të propozojë marrjen e masave të domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve të krijuara në mjedis nga vënia në jetë e këtij projekti;
4. Të propozojë masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për të minimizuar dhe parandaluar efektet e krijuara në mjedis nga zbatimi i këtij projekti.
5. Të mbrojë dhe rehabilitojë mjedisin natyror duke siguruar vazhdimësinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë florën dhe faunën në mjediset përreth zonës të marrë në konsideratë.
6. Të mbrojë trashëgiminë kulturore dhe promovojë zhvillimin e qëndrueshëm, në mënyrë që zhvillimi i infrastrukturës lokale të jetë një nga elementët kryesorë të vetë zhvillimit.
7. Të sigurohet që konsideratat mjedisore të trajtohen në mënyrë eksplicite dhe të përfshihen në procesin e vendimmarrjes.

II. LEGJISLACIONI DHE PROÇEDURAT MBROJTËSE TË MJEDISIT

2.1. LEGJISLACIONI MJEDISOR

Në Nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë shkruhet se: "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismës dhe të përgjegjësisë private, synon (1) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, dhe (2) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm,,. Nisur nga kompleksiteti i tyre, çështjet mjedisore synohet të përfshihen në të gjitha Planet Lokale e Rajonale të Veprimit, Strategjitë dhe Programet Sektoriale dhe Strategjitë Kombëtare.

Ligji mjedisor kryesor është Ligji Nr. 10431, datë 9 Qershor 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit". Ky Ligj përcakton politikat kombëtare dhe vendore për mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin dhe vlerësimin strategjik mjedisor, kërkesat për dhënien e lejeve veprimtarive që ndikojnë mbi mjedisin, parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit, normat dhe standartet mjedisore, monitorimin dhe kontrollin mjedisor, detyrat e organëve shtetërore në lidhje me çështjet mjedisore, rolin e publikut dhe sanksionet e përcaktuara në rast të shkeljes të ligjit. Ligji përcakton objektivat e mëposhtme të mbrojtjes së mjedisit:

- ✚ parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- ✚ ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- ✚ ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrjen e publikut;
- ✚ përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; dhe
- ✚ mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Ligji Nr. 10440 datë 7/07/2011 për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", përcakton rregullat, procedurat dhe afatet për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të projekteve ose veprimtarive mbi mjedisin. Ligji përcakton hapat e nevojshme për zbatimin e procedurave të VNM: dorëzimin e kërkesës, shqyrtimin paraprak, kriteret e përzgjedhjes dhe klasifikimit, seancat dëgjimore dhe konsultimet publike, aksesin në informacion, detyrat dhe të drejtat e organeve të tjera.

Ligji përcakton gjithashtu listën e veprimtarive që duhet të jenë objekt i procesit të Thelluar dhe atij Paraprake të VNM.

Ligji i lart-përmendur nënvizon se qëllimi i Vlerësimit Mjedisor është të sigurojë: *Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim dhe garantimin e një procesi të hapur vendim marrjeje gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve në mjedis në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.* Procesi i vlerësimit duhet të jetë i përgjithshëm, i integruar, në kohë, i hapur dhe të realizohet në mënyrë të paanshme nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore dhe vendore, publikut, si edhe organizatave mjedisore jo fitim prurëse, e zhvilluesve të projekteve si edhe të personave fizikë dhe juridikë të specializuar në këtë fushë, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e ndikimit mbi mjedis.

Disa nene të këtij ligji janë ndryshuar nëpërmjet Ligjit Nr. 12/2015 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ndryshime këto që kane hyrë në fuqi më 1 Shtator 2015.

Ligji Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njëriut dhe cilësisë së jetës. Ky ligj përcakton edhe rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Ne baze të Ligjit Nr. 60/2014 shtojca 1, bashkëlidhur Ligjit Nr. 10 448, date 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, është ndryshuar.

Tabelat me poshte tregojne Objektivat Kombetare te Cilesise se Ajrit per cdo ndotes, dhe limitet ose vlerat e synuara te Direktives Europiane ne perputhje me dy direktivat e BE: Direktivën 2008/50/EC mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe një ajër më të pastër në Evropë dhe Direktivën 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, mërkurin, nikelin dhe hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. Këto standarde dhe objektiva janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme (Tabela 1, 2 dhe 3).

Tabela 1. Vlerat limite te ndoteseve te ajrit bazuar ne shendetin human

| Ndotesi | Perqendrimi | Periudha mesatare | Tejkalimet e lejuara cdo | Afati per tu arritur |
|--|-------------------------------|--|---------------------------------|------------------------------------|
| Lenda Grimcore (PM2.5) | 25 µg/m ³ nga 2015 | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| | 20 µg/m ³ nga 2020 | 1 vit | | |
| PM10 | 50 µg/m ³ | 24 ore | 35 | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| | 40 µg/m ³ | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Diosksidi i Squfurit (SO₂) | 350 µg/m ³ | 1 ore | 24 | 5 vite nga adoptimi i strategjise |
| | 125 µg/m ³ | 24 ore | 3 | 5 vite nga adoptimi i strategjise |
| Dioksid Azoti (NO₂) | 200 µg/m ³ | 1 ore | 18 | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| | 40 µg/m ³ | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Plumb (Pb) | 0.5 µg/m ³ | 1 vit | n/a | 5 vite nga adoptimi i strategjise |
| Monoksid Karboni | 10 mg/m ³ | Maksimumi nje mesatare ditore 8 oreshe | n/a | 5 vite nga adoptimi i strategjise |
| Benzene | 5 µg/m ³ | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |

Tabela 2. Vlerat e synuara (target) te ndoteseve te ajrit

| Ndotsi | Perqendrimi | Periudha mesatare | Tejkalimet e lejuara cdo vit | Afati per tu arritur |
|--|---|--------------------------------------|--|------------------------------------|
| Ozone | 120 µg/m ³ | Maksimumi nje mesat. ditore 8 oreshe | 25 dite ne vit me mesatare te marre mbi 3 vjet | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Arsenik (As) | 6 ng/m ³ | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Kadmium (Cd) | 5 ng/m ³ | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Nikel (Ni) | 20 ng/m ³ | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Hidrokarburet policiklike aromatike | 1 ng/m ³ (shprehur si perqendrim i Benzo(a)piren) | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |

Tabela 3. Nivelet kritike per mbrojtjen e vegjetacionit

| Ndotsi | Perqendrimit | Periudha mesatare | Tejkalimet e lejuara cdo vit | Afati per tu arritur |
|---------------------------------------|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|
| Oksid Sulfuri (SO₂) | 20 µg/m ³ | Viti kalendarik dhe dimri (1 Tetor deri ne 31 Mars) | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Okside Azoti (NO_x) | 30 µg/m ³ | 1 vit | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |
| Ozoni. Vlere e synuar | AOT40 (llogaritur nga vlera 1h) 18000 µg/m ³ · h mesatarisht mbi 5 vjet | Maj deri ne Korrik | n/a | 10 vite nga adoptimi i strategjise |

Përpos sa më lart, përgatitja e kësaj VNM-je është bazuar në legjislacionin e mëposhtëm:

Ligje:

Ligji Nr. 81/2017, datë 18.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.

Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore”

Ligji Nr. 12/2015, datë 26.2.2015 "Për disa ndryshime në ligjin “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”

Ligji Nr. 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësise se ajrit në mjedis"

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"

Ligji Nr.111/2012, datë 15.12.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”

Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve,„

Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”.

Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2007 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”

Ligji Nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9385 “Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor”

Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”

Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujrave të Ndotura.

Ligji Nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e "Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”

Vendime të Këshillit të Ministrave:

V.K.M Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"

V.K.M Nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.

V.K.M Nr. 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të Lejeve të mjedisit”

V.K.M Nr. 227, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kerkesave dhe të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”.

V.K.M Nr. 175, datë 19.01.2011 ”Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”

V.K.M Nr. 587, datë 7.07.2010 ”Mbi monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbanë dhe turistike”

V.K.MNr. 994,datë02.07.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”

V.K.M Nr. 853, datë 28.12.2005 “Për miratimin e listes se mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera qe ndalohen të importohen me qëllime ruajtje, depozitimi dhe asgjесimi”

V.K.M Nr. 248, datë 24.04.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe zbatimin e tyre”.

V.K.M Nr. 435, datë 12.09.2002 “Për Miratimin e Normave të Shkarkimeve në Ajër në Republikën e Shqipërisë“

V.K.M Nr. 103, datë 31.03.2002 “Mbi Monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzime dhe Rregullore:

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Financave Nr. 7938, datë 17.7.2014 'Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së'

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Nr. 8 date 27.11.2007 ”Për nivelin kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara”

Gjithashtu, Shqipëria është palë e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi Biodiversitetin, Ndryshimet Klimatike, procesin e shkretëtizimit, Specieve në rrezik, Mbetjet e dëmshme, Ligjin mbi detin, Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Lagunave.

Gjatë hartimit të këtij raporti VNM-je, janë marrë në konsideratë edhe disa nga Direktivat kryesore të BE-së për mjedisin:

- ✚ Direktiva 1999/30/CE date 22Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit. (Council Directive 1999/30/EC of 22 April 1999 relating to

limit values for sulphur dioxide, nitrogen dioxide and oxides of nitrogen, particulate matter and lead in ambient air)

- ✚ Direktiva 2000/60/CE datë 23 Tetor 2000 për Kuadrin ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave. (*Directive 2000/60/EC of 23 October 2000 of the European Parliament and of the Council establishing a framework for the Community action in the field of water policy*).
- ✚ Direktiva 2001/42/CE datë 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin. (Directive 2001/42/EC of the European Parliament and of the Council of 27 June 2001 on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment).
- ✚ Direktiva 2011/92/EU e dates 13 Dhjetor 2011 mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve publike apo private (Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment).
- ✚ Direktiva 2008/50/CE datë 21 Maj 2008 Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”. (*Directive 2008/50/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe*).
- ✚ Direktiva 2014/52/EU datë 16 Prill 2014 mbi disa ndryshime në Direktivën 2011/92/EU mbi VNM (Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment). (Directive 2014/52/EU of the European Parliament and of the Council of 16 April 2014 amending Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment).

2.2. LEGJISLACIONI PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE

Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri ka përparuar me miratimin e ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve të reja. Qëllimet dhe afatet e parashikuara nga ligjet dhe strategjitë kombëtare janë në përputhje me kërkesat e BE. Një nga objektivat e rëndësishme të kuadrit ligjor dhe arsyeja kryesore e kësaj qasje nga lart-poshtë është krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorët ndërkombëtarë (në fonde të veçanta të BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme.

Ligji baze për menaxhimin e mbetjeve mbetet Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar me

Ligjin Nr. 156/2013 “Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 10 463, Datë 22.9.2011”

Ligji ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta. Për këtë qëllim, ai përcakton rregulla për trajtimin mjedisor të mbetjeve të ngurta në çdo fazë: krijimit, grumbullimit, ndarjes, transportit, riciklimit, përpunimit dhe deponimit. Ligji më tej ka për qëllim reduktimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimit të mbetjeve toksike dhe të rrezikshme. Ligji zbatohet nga:

- VKM Nr. 389, datë 27.6.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave “Për Lendfillet e Mbetjeve”
- VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”
- VKM Nr. 94, datë 14.2.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”
- VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”
- VKM Nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”
- VKM Nr. 117, datë 13.2.2013 “Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qenuri mbetje”.
- VKM Nr. 177, datë 6 mars 2012 "Për paketimin dhe paketimin e mbetjeve".
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Mbi miratimin e listës shqiptare për klasifikimin e mbetjeve”.
- Urdhër Nr. 893, datë 4.10.2013 “Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura”.

Amenduar nga:

Ligj Nr. 32/2013 datë 14.2.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

Ligj Nr. 156/2013 datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar”

Këto udhëzime nenvijzojnë nevojën për zbatimin e një hierarkie të menaxhimit të mbetjeve që përfshin parandalimin, riciklimin/ripërdorimin; trajtimin dhe asgjësimin. Udhëzimet kërkojnë ndarjen e mbeturinave konvencionale nga mbetjeve të rrezikshme dhe në qoftë se gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme nuk mund të parandalohet (siç është rasti në objektet e kujdesit shëndetësor); menaxhimi i tij duhet të fokusohet në parandalimin e dëmit ndaj shëndetit, sigurisë dhe mjedisit, në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Njohja dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme dhe rreziqeve që lidhen me menaxhimin e cdo lloj mbetje të rrezikshme të krijuar gjatë ciklit jetësor të saj të plotë.
- Sigurimi që njerëzit/firmat që merren me trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme janë ndërmarrje me reputacion dhe legjitime, të licencuara nga agjencitë përkatëse rregullatore dhe këto zbatohen praktikisht me të mira të industrisë.
- Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret e aplikueshme.

2.3. LEGJISLACIONI PËR PLANIFIKIMIN TERRITORIAL, TRASHËGIMINE KULTURORE DHE GJETJET E RASTESISHME

Projects for all types of building above ground and underground and engineering infrastructure projects across the entire country are based on standards and technical requirements of legal acts in force.

Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore si edhe të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e private. Ligji synon të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

Ligji zbatohet nga:

- VKM Nr. 408, datë 13.5.2015. Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”

- VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit".
- Regulation No. 739 date 13.12.2017 amending and supplementing Regulation No. 725 date 2.9.2015 on the organization and functioning of the Territory Development Agency.
- VKM Nr. 739, datë 13.12.2017. Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 725, datë 2.9.2015, “Per menyren e organizimit dhe funksionimit te Agjensise se Zhvillimit te Territorit”.
- VKM Nr. 725, datë 2.9.2015, “Per menyren e organizimit dhe funksionimit te Agjensise se Zhvillimit te Territorit”.

Amenduar nga:

- Ligji No. 28/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Ligji Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” është ligji baze që përcakton rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me zhvillimet transformuese në territor, ligji përcakton që: “Në rastet e zhvillimeve të mëdha, si: rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si edhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private, përpara marrjes së lejes përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, investitori duhet të marrë miratimin për projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, sipas legjislacionit në fuqi”.

Nëse, gjatë punimeve, ndeshen gjetje rastësore, punimet ndërpriten menjëherë dhe drejtuesi teknik ose investitori deklarojnë me shkrim, brenda tri ditëve, tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore për gjetjen rastësore.

Në rastet e zbulimeve të rëndësishme, punonjësi i autorizuar nga IKTK-ja ose subjekti i licencuar apo monitoruesi, urdhëron pezullimin e punimeve që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga KKTKM-ja.

III. PERSHKRIMI I MJEDISIT NE ZONEN E PROJEKTIT

3.1. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE ZONES

Bashkia e Përmetit, për vetë pozicionin e tij fiziko-geografik, përmban të katër brezat / zonat fitoklimatike që hasen në vendin tone: 1) Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare 2) Brezi i dushkajave 3) Brezi i ahishteve dhe 4) Brezi i kullotave alpine. Prania e këtyre brezave është një pasqyrim i madh i vlerave të florës, bimësisë dhe habitateve në këtë zonë.

3.1.1. Habitatet Natyror me Interes Komunitar, sipas Klasifikimit Natura 2000

Sipas hierarkisë së klasifikimit të habitateve natyrore në territorin Evropian, të listuara në manualin e interpretimit të habitateve (EC, 2007), janë 9 kategori të mëdha hierarkike klasifikimi që përfaqësojnë 233 tipe të ndryshëm habitatesh të listuara në këto kategori klasifikimi, disa prej tyre hasen në Bashkinë e Përmetit. Një pjesë e habitateve të zonës në studim përfaqësojnë habitate të degraduara, dhe si rrjedhim jo në Natura 2000. Përshkrimi i të gjithë habitateve është pasuruar me informacion të grumbulluar nga literatura si dhe nga vëzhgimet në terren.

*H- 9180 *Pyje të aleancës Tilio-Acerion të shpateve shkëmbore, çakëllishteve luginave të thata*

*H- 91BA *Pyje Moesiane me Bredh*

*H- 91K0 *Pyje Ilirike Fagus sylvatica (Aremonio-Fagion)*

*H- 92C0 *Habitatet e Lumit dhe Përroit (Platanus orientalis dhe Liquidambar orientalis (Plantanion orientalis))*

*H- 9340 *Shkurre/Pyje Sklerofîle Gjithmonë të Gjelbra – Macchia*

*H- 9530 *Pyll Halor – Dominuar nga Pinus nigra (Pisha e zezë)*

*H- 8210 *Gurë të Zhveshur me Bimësi të Rrallë.*

Fauna tokësore dhe ujore

Zona e Përmetit, përveçse shumë e pasur nga pikëpamja floristike, është e njohur gjithashtu dhe për pasuritë e saj faunistike. Me larmishmërinë e saj dhe format e terrenit, ndryshimet e mëdha në altitudo (nga shtrati i lumit Vjosa në lartësi 230m deri në majën e Papingut mbi 2482 m), ajo ofron mundësi të shumta ushqimi dhe strehimi për shumë specie. Këtu gjinden nga specie të rralla të habitateve ujore deri te gjetarë të mëdhenj. Zona shquhet

për praninë e shumë taksonëve të kafshëve dhe disa nga llojet invertebrore dhe vertebrore janë, gjithashtu të shumtë në numer.

Në lidhje me jovertebroret, specie e rrezikuar është flutura (Euphydryas aurinia) egzistojnë grupe të përbashkëta dhe të ndryshme të jovertebrore ujore, të cilat janë tregues të mirë të cilësisë së ujit, janë gjithashtu të zakonshme në këtë zonë. Vertebroret janë përfaqësuar nga të gjitha grupet, si amfibet, zvarraniket, zogjtë dhe gjitarët.

Për më tepër gjitarët përfaqësohen edhe nga lakuriqi hundepatkua i Mesdheut (*Rhinolophus euryale*), Lakuriqi hundepatkua i Blasit (*Rhinolophus blasii*) dhe lakuriqi i nates, veshmiu gishtëgjatë (*Myotis cappaccinii*), ketri (*Sciurus vulgaris*), gjumashi i majmëi pyllit (*Glis Glis*), gjumashi i lajthive (*Muscardinus avellanarius*),

Grumbujt e vjetër pyjorë të dushkajave ofrojnë nishe ekologjike të rëndësishëm për insektet (flatrafortët dhe fluturat), disa prej të cilëve kanë interes të veçantë ndërkombëtar dhe kombëtar për ruajtje, si *Cerambyx cerdo*, *Lucanus cervus*, *Carabus coriaceus*, *Osmoderma eremita*, *Papilio alexanor*, etj.

Me shumëllojshmërinë e habitateve që përmban, territori i bashkisë së Përmetit ofron mundësi për praninë e shumë llojeve të shpendëve të lidhur me ekosisteme dhe habitate të ndryshme. Lloje si Bufi - *Bubo bubo*, Huta bishtbardhë - *Buteo rufinus*, Gjeraqina këmbëshkurtër - *Accipiter brevipes*, Skifteri i Mesdheut - *Falco biarmicus*, Gjeraqina e shkurtës - *Accipiter nisus*, Shqiponja e maleve - *Aquila chrysaetos*, *Pernis apivorus*, Gjeraqina - *Accipiter gentilis*, Shqiponja gjarpërngrënëse - *Circaetus gallicus*, Kali i qyqes - *Neophron percnopterus*, Qukapiku i përhimë - *Picus canus*, Kukuvajka mjekëroshe - *Tyto alba* dhe Skifteri kthetrazi - *Falco tinnunculus*, janë të pranishëm dhe indikatorë të gjëndjes së ekosistemeve të zonës.

Drurët e tharë dhe të vjetër sigurojnë habitate të qëndrueshëm për një numër qukapikësh (*Dendrocopos syriacus*, *D. major*, *D. medius*, *D. minor*) dhe lloje të ndryshëm harabelorësh të tillë si trishtilat (*Parus spp*, *Aegithalos caudatus*), parosët, bilbilat dhe Zvarritësi i zakonshëm (*Sitta europaea*).

Reptilet përfaqësohen nga gjarprinjtë, shigjeta e gjate të Ballkanit (*Coluber gemonensis*), Bolla laramane (*Elaphe situla*), bolla me kater vija (*Elaphe quatuorlineata*), breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*), breshkujca Evropiane (*Emys orbicularis*) dhe zhapiku i Gjelbër Evropian (*Lacerta viridis*).

Lumenjtë dhe përrenjtë malorë, përbëjnë një habitat të rëndësishëm për llojet shtazore të lidhur me ujërat e freskët, si pilivesat, peshqit (troftat), amfibët dhe disa reptile. Amfibët janë një grup taksonomik zakonisht të lidhur me habitatet e ndryshme gjatë ciklit jetësor të tyre, me ujin dhe tokën. Amfibët më të njohura që hasen janë bretkosa barkverdhe (*Bombina variegata*) dhe

thithlopa (*Bufo bufo*). Lloje amfibësh tipik të lidhura kryesisht me habitatet ujore janë bretkosa e perrenjve - *Rana graeca*, bretkosa e zakonshme - *Rana balcanica*, Triton i madh - *Triturus cristatus*, etj.

3.1.2. Zonat e Mbrojtura

Sipas Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, zonë e mbrojtur është një hapësirë tokësore, ujore, detare e bregdetare, e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur, me kufij të qartë fizikë dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen/mbrojtjen afatgjatë të natyrës, e lidhur me shërbimet e ekosistemit dhe të vlerave kulturore.

Në kategorizimin e zonave të mbrojtura mjedisore dhe në përcaktimin e statusit për secilën prej tyre, institucionet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë mbështeten në kriteret e Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës (IUCN).

Kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore janë:

- a. “Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I)
- b. “Park kombëtar (kategoria II)”
- c. “Monument natyror (kategoria III)”
- d. “Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)”
- e. “Peizazh i mbrojtur (kategoria V)”
- f. “Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI)”
- g. “Park natyror bashkiak (kategoria IV)”, dhe
- h. “Kurorë e gjelbër (kategoria V)”.

Territori i Bashkisë Përmet, përfshin disa zona të mbrojtura sipas kategorive të lart-përmendura, sikurse mund të shihet në "Hartën e Zonave të Mbrojtura të Përmetit" (Figura 1). Në këtë listë është Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës - Dangëlli" (kategoria II) dhe 25 Monumente Natyror (Kategoria III).




Figura 1. Zonat e Mbrojtura në Bashkinë Përmet

Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës - Dangëlli"

Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës - Dangëlli" është shpallur i tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1631 date 17.12.2008. Parku është e vendosur në jug - lindje të Shqipërisë, në afërsi të qytetit të Përmetit, në veri - lindje të lumit Vjosa zë një sipërfaqe prej 34,361.05 ha. Nga sipërfaqja e përgjithshme e Parkut, në Bashkinë e Përmetit gjenden 33,165.3 ha, kurse në Bashkinë e Kolonjës gjenden 1,195.8 ha.

Brenda zonës së Parkut Kombëtar (PK) janë dy lugina të mëdha, lugina e Lomnicës dhe lugina e Lengaricës. Lugina e Lomnicës karakterizohet nga një kombinim i pyjeve të lisit dhe të bredhit dhe dy kanione të mrekullueshme ai i Kamenckës dhe Borockës. Lugina e Lengaricës është rreth 20 km e gjatë dhe kalon nëpër malësitë e Shqerisë dhe Dangëllisë në çdo anë. Lugina kalon nëpër zona me perberje të ndryshme strukturore dhe litologjike, duke bërë një zonë me diversitet morfologjik. Lugina është e ngushtë dhe të thellë në fillim duke u zgjeruar me shume në drejtim të rrymës, ku ajo bashkohet me lumin Gostivisht. Në shpatet e kanionit Lengarica ka një numër të konsiderueshem shpellash. Kullotat, e përdorura kryesisht për kullotje dhe livadhe, janë habitate që zene vendin e dyte për nga sipërfaqja.

Zonimi i Parkut Kombëtar "Bredhi i Hotovës – Dangelli" është e rregulluar me anë të VKM Nr. 1631, datë 17.12.2008, i cili përcakton zonimin si rregullim hapësinor të parkut në 4 zona të ndryshme. Këto zona janë të diferencuara në bazë të funksionit dhe të kushteve ekzistuese ekologjike, social- ekonomike dhe kulturore.

Zona e projektit nuk është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në asnjërën nga kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri sipas kategorizimit të IUCN, sikurse shihet në "Hartën e Zonave të Mbrojtura të Përmetit".

Territori në studim ku do realizohet projekti nuk shërben as edhe si zonë buferike, të cilat ruhen nëpërputhje me legjislacionin e Mjedisit në fuqi dhe në përputhje me politikat dhe planet që aplikon Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Zona në studim nuk bën pjesë as edhe në zonat e mbrojtura me interes të vecantë që mbrohen nga konventat ndërkombëtare, si: Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujore (konventa e Ramsarit); Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës); Konventa botërore e trashëgimise, etj.

Sipas hartës së Zonave me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, zona në studim ku do realizohet projekti nuk përfshihet në asnjë nga zonat me rëndësi.

3.1.3. Flora

Procesi i urbanizimit nëpër të cilin ka kaluar qyteti i Përmetit me kalimin e kohës ka çuar në degradim dhe humbje të një pjese të mjedisit të tij biologjik.

Megjithë ndryshimet e sjella nga urbanizimi, Përmeti ka mbajtur hapësira të gjelbërta si parku i qytetit të Përmetit.

Zona e projektit, e cila shtrihet në zonën urbane të Përmetit, nuk karakterizohet nga habitatet e pacenuara ose natyrore, peizazhet me vlera të rëndësishme skenike ose biodiversiteti (flora dhe fauna) me interes konservimi.

Flora e zonës së projektit mbizotërohet nga llojet e drurëve që përdoren kryesisht për qëllime dekorative. Në zonen e projektit gjenden drure halore te llojeve Ceder (*Cedrus libani* 'Glauca'); pishë e eger (*Pinus halepensis* L); por shumica janë fletore. Kështu në zonen e projektit gjenden rreth 40 drure panje (*Acer negundo*), 17 drure te llojit kumbull e kuqe (*Prunus cerasifera* 'Pissardii'); rreth 80 Drure te llojit Ilqe (*Quercus ilex*); 5 drure te llojit selvi (*Cupressum sempervirens*) te varietetit "Pyramidalis"; 135 drure te lloji bli fleteargjend ne rrugen "Meleq Gosnishti" dhe "Kongresi i Përmetit"; 25 drure te llojit robinia (*Robinia pseudoacacia* L); bime kacavjerrese si urthi (*Hedera helix*); trendafili i eger kacavjerres (*Rosa Madame Alfred Carriere*) apo (*Pyrostegia venusta*). Hardhia (*Vitis vinifera*) gjendet ne oborret e shume shtepive.

Bimesia barishtore përfaqësohet nga speciet e familjes Poaceae: elb deti (*Hordeum marinum*) dhe barishte shumëvjeçare si (*Lolium perenne*).

Meqenëse disa prej shtëpive në sit (qendra historike) nuk janë shfrytëzuar prej disa kohësh, vendi është kolonizuar nga disa specie bimore siç janë specie të ndryshme kacavjerrese.



Figura 2. Zone e Gjëlberuar prane Gurit te Qytetit



Figura 3. Drure pishe e eger (*Pinus halepensis*) pergjate kanalit “Perroi i bardhe”



Figura 4. Bimesi barishtore ne zonen e projektit



Figura 5. Bimesi barishtore ne zonen e projektit



Figura 6. Dru i ri frasheri



Figura 7. Bimesi barishtore



Figura 8. Bimesi qe rritet mbi rrenoja



Figura 9. Bime kacavjerrese ne shtepi te vjetra



Figura 10. Drure “Kumbulle e kuqe” pergjate trotuareve



Figura 11. Drure Selvie ne zonen e projektit




Figura 12. Harta e qarkullimit

3.2. MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK

3.2.1. Popullsia

Bashkia e Përmetit, si një ndër 61 njësitë e qeverisjes vendore, në krahasim me organizimin e mëparshëm është rritur në hapësirë dhe në numrin e banorëve. Ajo bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit tonë. Bashkia kufizohet në veri me bashkinë Skrapar, në lindje me bashkinë Kolonjë, në perëndim me bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë. Qendra e bashkisë është qyteti i Përmetit, i cili përfaqëson qendrën e zhvillimit ekonomik. Bashkia e Përmetit përbëhet nga 5 (pesë) njësi administrative: Përmet, Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë dhe ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra.

Të dhënat e Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë (Census 2011), paraqesin Bashkinë Përmet me një popullsi rezidente prej 10 614 banorë. Popullsia rezidente e aktualizuar vlerësohet të jetë 9 868 banorë, për një territor me një sipërfaqe prej 601.65 km².

Zona e projektit ndodhet në brendësi të qytetit të Përmetit (njësia Administrative- Përmet). Njësia Administrative Përmet regjistron numrin më të lartë të banorëve, më shumë se 55% të popullsisë së bashkisë, kurse Njësitë Administrative Frashër dhe Çarçovë, paraqesin një numër popullsie që nuk tejkalon 900 banorëve për njësi administrative. Në territorin e bashkisë Përmet vërehet një densitet mesatar tepër i ulët, me rreth 16 banorë/km², një vlerë gjashtë herë më e ulët se densiteti mesatar kombëtar prej 97 banorë/km².

Siç vërehet dhe nga Figura 13, qyteti i Përmetit ka densitetin më të lartë me rreth 2 888 banorë/km², ndërsa njësitë e tjera administrative paraqesin një densitet nën 10 banorë/km². Për më tepër njësia administrative Frashër, shënon një densitet mesatar më të ulët se 3 banorë/km². Densiteti ulët i popullsisë, është një tregues i karakterit rural të bashkisë Përmet.

Nëse krahasojmë popullsisë rezidente me popullsinë e regjistruar në Gjendjen Civile, vërehet një diferencë tepër e lartë, për shkak të disa faktorëve si p.sh: migrimi i popullsisë jashtë vendit dhe migrimi i brendshëm. Siç vërehet në hulumtimet e kryera në territor dhe konstatimet e Raportit Instat 2014, për “Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031”, kriza ekonomike botërore e viteve të fundit (2009-2012), ka patur një efekt pozitiv në rikthimin e popullsisë së migruar. Në këtë kontekst, studim më i detajuar mbi tendencat e popullsisë së regjistruar në gjendje civile, bëhet I domosdoshëm.




Figura 13. Pozicioni gjeografik i Përmetit dhe densitetet urbane (Burimi: PPV Përmet, 2018)

3.2.2. Zhvillimi ekonomik dhe Punesimi

Bashkia Përmet, për shkak të relievit që e karakterizon ka toka të pakta bujqësore, kryesisht këto toka shtrihen përgjatë Vjosës. Në zonat malore dhe ato kodrinore, banorët merren përgjithësisht me blegtori, bletari, vreshtari dhe pentari pasi bujqësia nuk është shumë e zhvilluar.

Vreshtaria është tepër e zhvilluar në Përmet, këtë gjë e dëshmon jo vetëm tradita e hershme që zona ka në prodhimin e verës dhe të rakisë në njësi familjar, por dhe 5 fabrika të cilat merren me prodhimin dhe përpunimin e nënprodukteve të rrushit.

Frutikultura-pemtaria është gjithashtu e zhvilluar për shkak të klimës së favorshme, si dhe traditës së vjetër që përmetarët kanë në prodhimin e rreçelrave, glikove dhe kompostove. Gjatë periudhës së komunizmit në Përmet ka pasur një kombinat ushqimor i cili merrej me prodhimin e këtyre produkteve, sot ato prodhohen nga njësi të vogla tregtare ose në kushte familjare. Drithërat prodhohen vetëm për konsum familjar. Blegtoaria është sektori më i zhvilluar dhe ekonomia bazë për shumë familje të cilat nuk kanë asnjë aktivitet tjetër ekonomik. Bagëtitë janë të dhirta dhe të leshta dhe shumë pak lopë. Çarshova, Petrani dhe Frashëri janë njësitë administrative me numrin më të madhë të krerëve të bagëtive dhe ekonominë e tyre e kanë të përqëndruar kryesisht në këtë sektor. Si rrjedhojë edhe përpunimi i qumështit për produkte bulmeti është një aktivitet i pranishëm në zone.

Ekonomia e turizmit është potenciali më i madh i zhvillimit, pas ekonomisë së bujqësisë, prandaj janë analizuar flukset jo vetëm të lëvizjes, por edhe të vendndodhjes së lokaliteteve me potenciale turistike dhe zonat që duhen ruajtur si potencial i lartë natyror.

Zona përbehet nga një territor tepër i larmishëm i cili zbërthehet në elemente të ndryshme natyrore, shumë prej të cilave janë monumente natyre. Aksi automobilistik nga Çarshova deri në Këlcyrë shoqerohet nga peizazhi që të ofron vargmali Nemërçkë-Dhembel-Trebeshinë si dhe nga lugina e Vjosës. Aksi tjetër peizazhistik është edhe rruga e vjetër që lidhte Përmetin me Leskovikun i cili kalon përgjatë një lugine të mbushur me katarakte, ujëvara dhe kanione. Turizmi i aventurës dhe turizmi malor janë të pranishëm përgjatë këtij aksi.

Krahina e Dangëllisë dhe krahina e Shqerisë të pasura me fshatra të vjetër me arkitekturë vernakolare, kisha të vjetra, monumente të shumta natyre dhe kulture. Ujërat termale të Benjës lujnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit kurativ.

Në Përmet është i zhvilluar turizmi fetar, si për kultin ortodoks ashtu edhe për atë bektashian. Krahina e Dangëllisë përqafon kryesisht besimin bektashian, ndërsa ajo e Shqerisë besimin ortodoks. Objektet e kultit mbartin vlera të shumta historike dhe kulturore.

3.3. TRASHEGIMIA HISTORIKE DHE KULTURORE

Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore

Në Territorin e Bashkisë Përmet ndodhen 2 Qendra Historike dhe 5 Zona Mbrojtëse Monumenti, konkretisht:

- ✚ "Qendër Historike e Qytetit të Përmetit" dhe Miratimi i Rregullores për Administrimin e saj dhe të Zonës së Mbrojtur përreth. Shpallur me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 32, datë 18.01.2017.
- ✚ "Qendër Historike e Fshatit Benjë" dhe Miratimi i Rregullores për Administrimin e saj dhe të Zonës së Mbrojtur përreth. Shpallur me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 776, datë 02.11.2016.
- ✚ Zona mbrojtëse e monumentit të kulturës "Guri i Qytetit", Përmet. Shpallur me Urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Nr. 28, dt. 29.01.2007.
- ✚ Zona Mbrojtëse e Urës së Katiut. Shpallur me Urdhër të Ministrit të Kulturës, Nr. 184, datë 06.05.2015.
- ✚ Zonë e Mbrojtur e Vendbanimit Shpellor, në Benjë, Shpallur me Urdhër të Ministrit të Kulturës, Nr. 184, datë 06.05.2015.
- ✚ Zonë e Mbrojtur e Kishës së Shën Mërisë, në Bënjë, shpallur me Urdhër të Ministrit të kulturës, Nr. 183, datë 06.05.2015
- ✚ Zonë e Mbrojtur e Mullirit të Drithit, pranë fshatit Bënjë, shpallur me Urdhër të Ministrit të Kulturës, Nr. 182, datë 06.05.2015.

Qendra historike Përmet

Qendra Historike e qytetit të Përmetit është pjesa më me vlera urbanistiko – arkitektonike e qytetit të cilën përfshihen gjini të ndryshme ndërtimore si: banesa popullore, objekte kulti dhe ndërtimeshoqërore.

Qendra Historike përfshin të gjitha ndërtimet ekzistuese dhe shtrihet kryesisht në lagjet e Shënkollit (Varosh) dhe të Teqesë, të cilat për nga kompozimi i ndërtimeve dhe rrugëve me kalldrëm, janë lagjet ku gjenden gjurmët më të vjetra të qytetit. Brenda Qendrës Historike përfshihen dy objekte kulti: Kisha e Shën e Premtes (ndërtuar në 1776), monument kulture i kategorisë së parë, dhe Kisha e Shën Kollit (ndërtuar në shekullin e XIX-të). Ansambli i ndërtuar paraqet tipologjiinteresante që përfshin një numër të konsiderueshëm banesash, të vendosura pranë njëra-tjetrësme oborre të vegjël dhe një rrjet rrugicash të ngushta të shtruara me kalldrëm dhe kunetë në mes, porta të jashtme druri me perimetër me mure guri. Ndërtimet në përgjithësi janë dy-katëshe dhe tëndërtuara me mure guri. Arkitektura është karakteristike e fshatrave tradicionalë të zonës dhe pjesa dërrmuese e ndërtimeve janë të pas Luftës së Dytë Botërore.

Zona e mbrojtur rrethon Qendrën Historike të Përmetit, shtrihet në pjesën më të madhe veri-perëndimore të saj. Zona e Mbrojtur përbëhet nga një zonë e gjelbër dhe një zonë me ndërtesa të mëvonshme, dhe mundëson një kalim të butë prej Qendrës Historike drejt pjesëve më të reja të qytetit. Në këtë zonë ruhet pjesa e kurorës së gjelbër, rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik. Kjo zonë si pjesë përbërëse e Qendrës Historike, ruhet në tërësinë esaj dhe ka elemente që u shërbejnë pamjeve panoramike të Qendrës Historike.

Qendra historike e fshatit Bënjë

Qendra e Bënjës mban Statusin “Qendër Historike” që prej nëntorit 2016; shpallur “Qendër Historike” me VKM nr. 776, dt. 02.11.2016. Qendra Historike e fshatit Bënjë përfshin pjesën më të madhe të ndërtimeve, si dhe hapësirat e gjelbra që ndodhen brenda kufijve të saj. Qendra e fshatit përbëhet nga një kompozim kompakt tradicional që zhvillohet në faqen e kodrës. Kisha e Shën Mërisë, Monument Kulture i Kategorisë së Parë, është ndër elementët më të rëndësishëm arkitektonikë të fshatit Bënjë. Banesat janë objekte kryesisht dy katëshe, ndërtime të fundshekullit të XIX dhe fillimit të shekullit të XX. Janë të ndërtuara me mur me gurë gëlqerorë, lidhur me llaç gëlqere, mbuluar me çati me rrasa guri. Qoshet e mureve dhe të dyerve e dritareve janë të punuara me gurë të latuar me kujdes. Rrugicat e fshatit janë të shtruuara me kalldrëm.

Zona e mbrojtur e fshatit Bënjë shtrihet përreth Qendrës Historike. Ajo mbron vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë drejt pjesës tjetër të fshatit. Në pjesën jug-lindore ajo përfshin edhe një pjesë të rrugës hyrëse për në fshat dhe, nisur edhe nga konfiguracioni i terrenit, shërben për të mbrojtur më mirë peizazhin arkitektonik.

Monumente Kulture

Në territorin e Bashkisë Përmet ndodhen 25 Monumente Kulture, të gjitha të kategorisë së parë. Në vijim jepet një përshkrim i shkurtër për disa prej tyre.

Guri i Qytetit – Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Instituti i Shkencave, Vendim nr.95/ dt.16.10.1948. Guri i qytetit është një gur masiv me faqe të thikta, 12 m i lartë. Në pjesën e sipërme, shkëmbi rrafshohet në një suprinë 15x15m në të cilën ruhen rrënojat e një fortifikimi të shekullit IV-VI. Në rrëzë të shkëmbit ndodhet një trakt i periudhës antike, i njëjtë me fortifikimet e shekullit të III-të p.e.s. në luginën e Drinos. Në sipërfaqe të gurit gjenden dy ambiente të rrënuara. Njëri nga ambiente me sipërfaqe 14 m² është përdorur si ujëmbledhës. Ambienti tjetër ka një sipërfaqe 22.5 m². Muri është izodomike me blloqe gëlqeror në trajtë katërkëndëshi me përmasa rreth 1x045m me faqe bashkimi të latuara mjaft mirë dhe ballë të rrafshët.

Shpella e Benjës – Benjë, Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim nr.1886/ dt.10.06.1973. Në hyrje të kanionit të Langaricës, në lartësinë 8m mbi nivelin e lumit ndodhet vendbanimi shpellor, i cili i përket periudhës së neolitit. Shpella përbëhet prej shkëmbinjve gëlqeror. Gjatësia e brendshme e shpellës është 16m me gjerësi 3m dhe lartësi 3m. Në qendër të saj ndodhet një hapësirë tjetër me thellësi 9m, gjerësi 3m dhe lartësi 3m. Hyrja e shpellës përbëhet nga 4 hapësira: hyrja e parë: 5m gjerësi dhe 3m lartësi; hyrja e dytë: 2.5m gjerësi dhe 2.5m lartësi; hyrja e tretë: 1.4m gjerësi dhe 1.4m lartësi; hyrja e katërt: 5m gjerësi dhe 3m lartësi.

Ura e Katiut– Benjë, Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim nr. 1886/ dt.10.06.1973. Në qendër të kompozimit të urës ndodhet harku kryesor në formë segmenti rrethor me hapësirë drite 15.5 m dhe lartësi 6 m mbi nivelin e ujit. Përfshirë dhe arkivoltën, qemeri i harkut ka trashësi 1 m dhe është punuar me gurë gëlqeror pllakë. Qemeri konturohet nga sipër prej arkivoltës me trashësi 50 cm, e ndërtuar dhe kjo me gurë gëlqerorë, e cila del me dhëmbë 10 cm mbi ballin e qemerit të poshtëm. Në pjesën e kyçit të harkut ura ngrihet me kurriz, me lartësi 7 m mbi nivelin e ujit. Gjatësia totale e urës në projektionin horizontal arrin 37 m. Majtas harkut kryesor është hapur një dritare lehtësuese me gjerësi 1.3 m dhe lartësi 2.7 m. Kalldrëmi i urës është ndërtuar me gurë shtufi pllakë vendosur këllaç. Nga të dy anët e kyçit ngrihen 5 cm, mbi kalldrëm dy rreshta tërthorë me gurë lumi, që lehtësojnë ngjitjen mbi kurrizin e urës (Figura 14).

Ura në Përroin e Benjës – Benjë, Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim nr.1886/ dt.10.06.1973. Ura është e pozicionuar në të hyrë të fshatit Benjë, në lagjen e poshtme të tij që kalon nëpër njëgrykë të ngushtë e derdhet në lumin Lengaricës. Ka një harmonizim të bukur me ambientin rrethues.

Kisha e Shën e Premtes – Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim nr.1886 / dt.10.06.1973. Është kishë e shekullit të XVIII; muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi të zi, lidhur me llaçgëlqereje. Pjesa e absidës shtatë-faqëshe është punuar me gurë të skuadruar dhe me nike të mbuluar me harqe tullash. Është kishë e shekullit të XVIII; muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi të zi lidhur me llaçgëlqereje. Pjesa e absidës shtatë-faqëshe është punuar me gurë të skuadruar dhe me nike të mbuluar me harqe tullash. Edhe në murin lindor, në të dy anët e absidës ka nga dy nike. Ky objektokulti përbëhet nga narteksi, naosi, ambienti i altarit dhe hajati.



Figura 14. Ura e Katiut- Benjë

Kisha e Shën Mërisë - Leusë – Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim nr.1886 / dt.10.06.1973. Është kishë e shek XVIII; Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi lidhur me llaç gëlqereje. Ato janë të rrafshta dhe pa ndonjë zbukurim. Çatia është dyjësë me rrasa guri dhe mbi të del tamburi.

Teqja e Frashërit- Frashër, Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr. 1886 / dt.10.06.1973. Është ndërtim i shekullit të XVIII; Teqeja përbëhet nga dy ndërtesa të veçanta, të cilat lidhen me njëmur dhe në qendër të saj ka një portë me qemer. Ndërtesa ndodhet në krahun e djadhtë, ka formën e gërmës '1' me sipërfaqe 325 m², e cila zhvillohet në tre ambijente “kafe oxhaku”, “ashefi”, “furra e bukës”. Ndërsa në krah të majtë është pjesërisht dy katëshe me sipërfaqe 218 m². Aty ndodhet mejdani, vendi i shenjtë ku zhvillohen ceremonitë fetare dhe shkolla me përmbajtje fetare bektashiane. Në distancë prej 20 m ndodhen dy tyrbe bashkë me kupola dhe hyrje të veçanta me sipërfaqe 102 m².

Kalaja e Bolengës: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim nr.1886/ dt.10.06.1973.

Ikonomstasi i Kishës së Shën Mërisë, Benjë: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Kulturës me Vendim nr.68/7, dt.30.05.1970.

Ikonostasi i Kishës së Shën Mërisë, Ogdunan: Shpallur Monument Kulture nga Komiteti i Kulturës dhe Arteve me vendim nr.8, dt. 18/12/ 1987

Banesa e Lefter Cullufës: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës), Vendim nr.266/1, dt.16.02.1979

Shtëpia e Vëllezërve Frashëri: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim nr. 1886, dt.10.06.1973

Banesa e Jani Jorgjit: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim nr. 1886, dt.10.06.1973

Banesa e Konstandine Londos: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim nr. 1886, dt.10.06.1973

Ura e Dashit mbi Përroin e Benjës në mes të fshatrave Benjë e Vinjah: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dt.08.01.1977

Pus karakteristik në shtëpinë e Ali Muhametit në fshatin Kala – Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vendimnr. 266/ dt.06.02.1979.

Çezma e Pacomitit – Pacomit, Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vendim nr.266/ dt.06.02.1979.

Mulliri i Drithit buzë lumit të Lengaricës – Benjë, Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vendimnr. 786/1 / dt.05.11.1984.

Banesa e Ylli Imamit dhe Lilo Vangjelit – Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr. 266/1, dt.16.02.1979.

Ndërtesa ku u mbajt Kongresi i Përmetit – Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr. 1886/ dt.10 .06.1973.

Tavan dekorativ në banesën e Jeko Karafilit- Qendër Piskovë – Përmet: Shpallur Monument Kulture nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr. 266/1 / dt.16.02.1979.

3.4. MJEDISI FIZIK

3.4.1. Gjeologjia

Përshkrimi gjeologjik është bazuar në Hartën Gjeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000, botimi vitit 2004, në tekstin sqarues të saj si dhe Hartat gjeologjike Shkallë 1: 100.000 të qarqeve të botuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar.

Në pikëpamje gjeologjike në territorin e Bashkisë Përmet dallohen dy sektorë me ndërtim gjeologjik të ndryshëm, sektori perendimor dhe sektori lindor:

Sektori perendimor përfshin gjithë pjesën e lartë malore, si mali i Trebeshinës, i cili ndërtohet nga shkëmbinj karbonatikë që në pikëpamje moshore fillojnë nga Jurasiku i poshtëm deri në Eocen (Figura 15). Formacionet karbonatike janë të ndryshme; ato më të vjetrat Jurasiket, karakterizohen nga gëlqerorë, gëlqerorë mergelorë dhe argjilorë shtresë hollë dhe pllakorë me stralle. Gëlqerorë e kretakut zakonisht janë shtresë hollë deri në shtresë trashë, shpesh janë argjilorë dhe porcelanikë.

Gëlqerorët e paleocenit dhe të eocenit janë kryesisht turbididikë, shtresorë. Sektori lindor i Bashkisë Përmet, fillon që nga mezi i lartësisë së shpatit lindor të sektorit malor, dhe mbulon krejt territorin e bashkisë deri në ujëndarësin me Qarkun e Korçës (Figura 15). Flishet janë të moshës së eocenit (Pg2) dhe të oligocenit (Pg3) dhe përfaqësohen kryesisht nga ndërthurre ritmike shtresash argjilore, alevrolitor dhe ranore.

Depozitimet më të reja, ato të holocenit, përbëjnë një mbulesë dherash aluviale të shkriфта kokërdryshme nga zhavorre deri në argjila si dhe shtresa konglomeratike. Ato përhapen vetëm në luginën e lumit Vjosa ku ndërtojnë terracën e parë mbizallishtore dhe kanë trashësi maksimale rreth 20 m. Në pjesën e poshtme të tyre depozitimet holocenike përmbajnë shtresa të trasha konglomeratësh.



Figura 15. Harta Gjeologjike e Bashkise Përmet (Burimi: Sherbimi Gjeologjik Shqiptar)

3.4.2. Hidrogeologjia

Kushtet hidrogeologjike të territorit të Bashkisë Përmet paraqiten në hartat hidrogeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000 dhe në atë me shkallë 1:100.000 (Figura 16). Kjo zonë karakterizohet nga prania e tre tipeve shkëmbinjsh me karakteristika hidrogeologjike krejt të ndryshme: shkëmbinj gëlqerore, shkëmbinj flishorë dhe dhera zhavorrore-argjilore. Shkëmbinjtë gëlqerorë përmbajnë rezerva të mëdha ujërash nëntokësore. Ata ndërtojnë pjesën perendimore të territorit dhe lidhen me malin e Dhëmbelit. Gëlqerorët kanë çarshmëri të lartë si dhe janë të karstëzuar gjë që manifestohet me hapësirat e mëdha karstike që ato përmbajnë si karie, hinka dhe shpella karstike. Si rezultat infiltrimi i rreshjeve atmosferike në to është i lartë, zakonisht mbi 50% e rreshjeve shkon për ushqimin e ujërave nëntokësore karstike.

Po te kemi parasysh sipërfaqen e madhe që zënë gëlqerorët (rreth 70-80 km²), si dhe sasinë e madhe të rreshjeve vjetore në këtë zonë (rreth 1400 mm) kuptojmë se rezervat e përgjithëshme të ujërave karstike janë mesatarisht disa m³/s, ose rreth 50.000.000 m³/vit. Rezervat e mëdha të ujërave karstike që formohen në malin e Dhëmbelit lëvizin drejt Grykës së Këlcyrës ku edhe drenohen në formë burimesh të mëdhenj prurja e të cilëve është shumë e ndryshueshme gjatë vitit. Si rrjedhim në territorin e Bashkisë Përmet nuk dalin burime karstike të rëndësishëm.

Burime relativisht të mëdhenj me prurje 3-4 deri rreth 10 l/s dalin vetëm në afërsi të Përmetit si dhe afër fshatit Lashovë dhe Strembec.

Shkëmbinjtë flishorë, të treguar në Hartë me ngjyrrë bezhë (Figura 16) zënë mbi dy të tretat e territorit të Bashkisë. Këta shkëmbinj të cilët përfaqësohen nga ndërthurje ritmike shtresash alevrolitesh, argjilash dhe ranorësh dallohen për porozitet aktiv shumë të ulët. Si rrjedhim flishet paraqiten si shtresa ujë-izoluese dhe nuk përmbajnë rezerva ujërash nëntokësore të rëndësishme.

Vetëm në rastet kur shtresat ranore paraqiten më të trasha ato përmbajnë rezerva ujore të vogla dhe formojnë burime zakonisht me prurje rreth 0.1-03 l/s. Pjesa më e madhe e fshatrave të Bashkisë së Përmetit vendosen në formacione flishore dhe rrjedhimisht ndejnë së tepërmi mungesën e ujit si për nevoja komunale ashtu edhe për ujitje.

Dhera zhavorrore-argjilore mbushin pjesën e sipërme të luginës së lumit Vjosa ku përhapjen më të gjërë e kanë teracat aluviale që përhapen në veri të Përmetit. Në luginën e lumit Vjosa depozitimet zhavorrore përmbajnë shtresa të trasha konglomeratike të cilat në sipërfaqe kanë një mbulesë suargjilore. Trashësia maksimale e dherave zhavorrore-argjilore është rreth 20-25. Këto dhera nuk janë studjuar mirë nga pikpamje hidrogeologjike por disa shpime

Prurja e lumit gjatë vitit është mjaft e ndryshme; sipas të dhënave të “Hidrologjisë së Shqipërisë” – 1984, rrjedhja mesatare vjetore në Përmet është 74.4 m³/s (pellgu ujor 2810 km²), kurse rrjedhja vjetore me siguri 90% është 51.3 m³/s. Prurjet më të mëdha të lumit në përmet luhaten rreth 750 m³/s kurse ato më të vogëlat janë rreth 35-40 m³/s.

Vjosa për shkak të mbizotërimit të gëlqerorëve në pellgun e saj ujëmbledhës, rradhitet ndër lumenjtë më pak erozivë të Shqipërisë. Prurja e saj e ngurtë në derdhje arrin 212 kg/sek, turbullira mesatare 1087 gr/m³ dhe moduli i aluvioneve 997 ton/ km² në vit. Ujrat e Vjosës kanë mineralizim mesatar 335 mg/lit.

Pellgu ujëmbledhës i Vjosës është i pasur në ujëra nëntokësore. Por ana e majte dallohet nga ana e djathtë pasi akuiferet këtu janë të varfër. Pra zone e mbulimit të lumenjve Lumnica, Langarica dhe Çarshova përbëhen kryesisht nga shtresa të padepërtueshme, shkëmbinj me aftesi mbajtëse shumë të dobët të ujit. Në këtë anë depozitimi është flish.

Lumi Lemnica ka një pellg ujor prej 103 km² i cili i gjithi ndodhet brënda territorit të Bashkisë Përmet. Prurja mesatare vjetore e Lemnicës në derdhje (në lumin Vjosa) është 2.11 m³/s, kurse prurja me sigurin 90 është 1.27 m³/s. Ky lumë ka më shumë karakterin e një përroi malor i cili karakterizohet nga prurje shumë të mëdha në periudhë rreshjesh torençiale, prurja mesatare maksimale është 131 m³/s, kurse prurjet maksimale absolute i kalojnë 270 m³/s. Dega e lumit Lemnica në anën e djathtë të lumit Vjosa, buron në zonën e Frasherit. Lugina e Lemnicës buron në malin Kokojka me një lartësi prej 1500 m mbi nivelin e detit, dhe përfundon në fshatin Piskove, kur takohet me lumin Vjosa.

Rrjedhat kryesore janë Vlana dhe Stroponi me shkarkim në lartësi prej 520m mbi nivelin e detit, deri në fshatin Progrid. Në rrjedhen e poshtme, lumi Lomnica, 410m mbi nivelin e detit, bashkohet me perroin e Turbullt. Deri në lumin Vjosa një numër perrenjsh shkarkojnë ujin e tyre në anën e djathtë të lumit Lemnica. Nga e majta perrenjte e Frasherit dhe Hotoves

Lumi Lëngarica mbledh pjesërisht ujërat e Bashkisë së Kolonjës dhe pjesërisht ato të Bashkisë së Përmetit. Në “Hidrologjia e Shqipërisë” jepen të dhëna për stacionin Petran të lumit të Lëngaricës I cili ndodhet në Bashkinë e Përmetit dhe ka sipërfaqe ujëmbledhëse 337 km². Prurja mesatare e këtij lumi në Petran është 8.22 m³/s, prurja me siguri 90% është 5.34 m³/s dhe prurja maksimale mbrin 251 m³/s.

Lumi i Langaricës. Lumi i Langaricës buron nga mali Kamenikut (2,048m mbi nivelin e detit). Rrjedh përmes fshatit të Shalës, ku merr emrin perroi i Shales dhe me pas merr emrin e tij lumi i Lëngaricës dhe Sanjollas kur bashkohet me perroin e Barmashit.

Lumi (Përroi) i Çarshovës. Perroi i Çarshoves buron nga vend karstik i zonës se Leskovikut, nga malet Lipe me një lartësi prej 1490m mbi nivelin e detit. Ajo përbëhet nga dy degë kryesore perrenjte Çarshova dhe Postenani të cilat shkarkojne ujirat e tyre në lumin Vjos në fshatin Çarshova. Zona ujëmbledhëse e këtij përroi është e 90.8 km² dhe lartësia mesatare është 1000 m mbi nivelin e detit.

Lumi e ndërton luginën e tij mes depozitimeve të terraces së parë e cila në pjesën e poshtme është e moshës Plio-Kuaternare dhe që sipër mbulohet nga depozitime të shkrufta aluvialo-eluviale të Holocenit të sotëm me trashësi 3-4m. Terraca, në të dyja krahët e shtratit, ka një shtrirje prej disa qindra metrash dhe shfrytëzohet si tokë bujqësore.

Brigjet e shtratit bien me kënd të fortë thujse vertikal drejt rrjedhës ujore. Disnivele i urës nga terraca e parë është 3,5-4m më poshtë saj. Vetë ura, në mes është rreth 1m më e lartë se në skajet e saj. Regjimi ujor i tij është kryesisht pluvial. Sasia e prurjeve ujore në shtrat luhatet në funksion të stinës, rreshjeve atmosferike, shkarkimeve anësore, shfrytëzimit të rezervës ujore për nevoja të komunitetit, etj. Vlerat maksimale e prurjeve ndodhin gjatë muajeve Shkurt (2.9 m³/s), kur reshjet kane vlere me te larta. Vlerat e larta të muajit Nëntor dhe Dhjetor korrespondojne me fillimin e reshjeve. Muajt me te thate janë Korrik dhe Gusht (0.230 m³/s), që korrespondojne me rreshjet si gjate muajve Mars-Prill ku rrjedha furnizohet me dëborë të shkrirë. Shkarkimi i këtij lumi është 1.49 m³/s.

Furnizimi me ujë. Nga përshkrimi i paragrafit të mësipërm mund të kuptojmë se si rezultat i kushteve hidrogeologjike në përgjithësi të disfavorëshme, furnizimi normal i popullsisë së Bashkisë Përmet është tepër i vështirësuar. Përbashkërisht bën vetëm qyteti i Përmetit i cili ka sistm të centralizuar të furnizimit me ujë. Qyteti furnizohet me ujë nga dy burime karstik, njëri del në pjesën jugëperendimore të qytetit dhe tjetri në fshatin Gjinkarnë. Burimet kanë prurje të përbashkët rreth 5 deri 15 l/s. Po kështu në periferinë jugore të qytetit ka edhe një shpim i cili përdoret gjithashtu për furnizimin me ujë të qyteti; pusi ka prurje rreth 7 l/s. Mirë paisja dhe mirëmbajtja e sitemit të furnizimit me ujë lë shumë për të dëshëruar dhe si rrjedhim popullsia e qytetit ndjen mungesën e furnizimit normal me ujë.

3.4.4. Cilesia e Ajrit

Emetimet e gazrave (për të cilat nuk ka të dhëna analitike, duke qenë se stacionet e regjistrimit përqendrohen në qendra të mëdha urbane) vlerësohet se janë mjaft të kufizuara për shkak të numrit të ulët popullsisë, konsumit të ulët të energjisë shtëpiake dhe të ngarkesës së qarkullimit, por edhe dhe

aktiviteteve profesionale të kufizuara. Djegia e drurit për ngrohje përbën një faktor tjetër të ndotjes nëpërmjet emetimit të mikrogrimcave, por përsëri, për shkak të shkallës së vendbanimeve, ky fenomen është relativisht i kufizuar, siç janë gjithashtu edhe pasojat e tij.

Sipas Bankës Botërore, emetimet në CO₂ për banor për vitin 2014, luhaten rreth vlerës 2.0 tonë metrikë. Nga të dhënat e popullsisë së Bashkisë për vitin 2016 në kombinim me të dhënat e Bankës Botërore për emetimet e dioksidit të karbonit për vitin 2014, u përllogarit emetimi i CO₂ për çdo njësi administrative në Bashkinë Përmet (Tabela 4).

Tabela 4. Sasia e CO₂ të emetuar për çdo njësi administrative në Bashkinë Përmet

| Njësitë Administrative | Sipërfaqe (km²) | Popullsia 2016 | Emetimet e CO₂ (ton metrik) |
|-------------------------------|-----------------------------------|-----------------------|---|
| Çarçovë | 155.4 | 884 | 1768 |
| Frashër | 131.2 | 353 | 706 |
| Përmet | 1.9 | 5,496 | 10902 |
| Qendër piskovë | 161.4 | 1,614 | 3228 |
| Petran | 152.0 | 1,521 | 3042 |
| Bashkia Përmet | 601.65 | 9,868 | 19736 |

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, LNP, PM₁₀, NO₂, SO₂, Pb, O₃, CO dhe BTEX në stacione të përzgjedhura qëllimisht në zonat urbane më të rënduara, përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të reflektuara edhe në VKM nr 803, date 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”.

Ndotja nga PM₁₀ dhe PM_{2.5} sipas rekomandimeve të OBSH është rreziku më i madh shëndetësor sot për ajrin urban në shkallë botërore, pasi grimcat me përmasa nën 10 mikron dhe 2.5 mikron mund të depërtojnë në pjesën e poshtme të mushkerive.

Kjo ndotje vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe është karakteristike për makinat e vjetra me motor dizel. Gjithashtu ndërtimi dhe infrastruktura në ndërtim janë kontribues në rritjen e PM₁₀. Nga rezultatet e monitorimit të PM₁₀ dhe PM_{2.5}, përmbajtja mesatare vjetore e PM₁₀ nuk e tejkalon normën Shqiptare dhe standartin e BE në asnjë nga stacionet e monitoruara por problematik ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ku kemi tejkalim të ditëve që janë më të larta se norma ditore (Norma është 35 ditë të tejkaluara në vit)

Në vlerësimin e cilësisë së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të të cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin.

Në bazë të të dhënave të monitorimit urban, në qytetin e Përmetit (zona e projektit), ajri në përgjithësi rezulton i pastër nga ndotësit e gaztë (SO₂ dhe NO₂), pasi në të gjithë stacionet e monitoruara vlerat mesatare vjetore janë brenda normave të lejuara të standartit shqiptar dhe standartit të BE. classified as primary and secondary

3.4.5. Zhurmat (Ndotja Akustike)

Ndotja akustike i detyrohet kryesisht trafikut rrugor, ku nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dBA (në zonat të dendura të trafikut rrugor). Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor “i dukshëm”. Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës.

Ndotja akustike ka efekte negative mbi shëndetin, në të njëjtën kohë direkte dhe të grumbulluara (të akumuluar).

Presioni akustik është një matje bazë e vibracioneve të ajrit që përbëjnë zhurmën. Meqënëse intervali i presionit akustik, që auditori human mund të zbulojë (dallopë), është shumë i gjerë këto nivele i matim me një shkallë logaritmike me njësi decibel (dB).

Niveli i zhurmave urbane (LAeq): është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjithë burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.

Monitorimi i zhurmave urbane i kryer nga Instituti i Shëndetit Publik ka për qëllim matjen e nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 8 qyteteve kryesore të vendit tonë, për të dhënë mundësinë që të gjykohet mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave. Kur niveli i zhurmave është rreth 65 dBA, gjumi bëhet shqetësim serioz dhe shumica e popullatës bezdisen.




Figura 17. Nivelet e zhurmës të dëmshme për shëndetin njerëzor (Source: iwan-ae.info)

Në këtë rast, zhurma në komunitet, bëhet një problem i vërtetë i shëndetit mjedisor. Edhe në vendin tonë, zhurma është një nga rreziqet mjedisore, që vazhdon të evoluojë dhe mund të krijojë probleme tek ajo pjesë e personave që janë të ekspozuar. Veçanërisht, ndotja nga trafiku rrugor është bërë problematike dhe mjaft shqetësues. Ne figuren 17 është paraqitur grafikisht ndikimi që nivele të caktuara të zhurmës kanë mbi shëndetin e njerëzve).

Në mungesë të matjeve zyrtare nga Instituti i Shëndetit Publik ose Agjensia Kombëtare e Mjedisit, për të matur nivelin e zhurmës në qytetin e Përmetit kemi përdorur një Matës të Nivelit të Tingullit UNI-T UT353BT (30-130dB Decibel) (Figura 18). Matjet janë realizuar në ditë të ndryshme dhe në tre pika brenda qytetit. Të dhënat e marra nga monitorimi tregojnë se niveli i zhurmës në qytetin e Përmetit paraqitet pothuajse homogjen për sa i përket intervalit

të luhatjes së zhurmës në pika të ndryshme monitorimi dhe ato janë brenda kufijve. Niveli më i lartë i zhurmës së regjistruar ishte 57.9 dB (A) dhe 46.1 dB (A) përkatësisht për ditë dhe natën.



Figura 18. UNI-T UT353BT Sound Level Meter 30-130dB Decibel

3.1.1. Rreziku Sizmik në Përmet

Vlerësimi i rrezikut sizmik të rajoneve të ndryshme të prekur nga tërmetet, është bërë njëdrejtim i preferuar i sizmologjisë kryesisht gjatë dekadave të fundit. Në vitin 1979, u realizua studimi “Rajonizimi Sizmik i Republikës së Shqipërisë” së bashku me hartën përkatëse në shkallën 1:500.000 (Sulstarova et al, 1980). Që nga ajo kohë e në vazhdim Hartae Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë në shkallën 1:500.000 është pjesë integrale e Kushteve Teknike të Projektimeve e Ndërtimeve Antisizmike – KTP N2-1989.

Harta e Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë paraqet efektin maksimal sipëfaqësor të pritshëm për kushte mesatare trualli, të shprehur në intensitetin bazë të përcaktuar sipas shkallës MSK-1964. Intensiteti bazë është konsideruar si intensiteti maksimal i vrojtueshëm në një pikë të dhënë për një periudhë kohore të caktuar në të ardhmen.

Në Hartën e Rajonizimit Sizmik të Shqipërisë janë dalluar tre kategori zonash: zonat me intensitet bazë të lëkundjeve VIII, VII e VI ballë; brënda zonave VIII

ballëshe për kushte tëkëqia trualli, të përmëndura më lart, janë dalluar zona me intensitet të pritshëm IX ballë.

Në botimin e fundit “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri”, në të cilin përfshihet përvoja mbi 40 vjeçare e studimeve në fushën e sizmologjisë, jepen përfundime të arritura nëpërmjet debatit shkencor ehulumtimit të thellë dhe kulmohet me formën më të plotë të rrezikut sizmik të vendit, njëdokumentacion me rëndësi praktike për ndërtimet në Shqipëri.

Sipas EuroCode 8, strukturat në rajonet sizmike duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë tëtillë që të kënaqin këto dy kërkesa themelore:

1. Kërkesa e mos-shëmbjes, dhe
2. Kërkesa e kufizimit të dëmtimeve.

Pra, për të plotësuar këto dy kërkesa të Eurokodit 8, llogaritjet e rrezikut sizmik të Shqipërisëjanë kryer për dy nivele probabiliteti:

- ✚ 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (10%/50), ose 0,0021 në vit, që i korespondonnjë tërmeti me periodë përsëritje 475 vjet, dhe
- ✚ 10% probabilitet tejkalimi në 10 vjet (10%/10), ose 0,0105 në vit, që i korespondonnjë tërmeti me periodë përsëritje 95 vjet.

Në zonimin sizmik mbarëbotëror, Shqipëria zë vënd në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është ndër me aktivet ne botë. Në këtë brez, pjesa më aktive nga pikpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon (34-43o N dhe 18-30o E), ndodh të paktën një tërmet me $M > 6.5$ (Papazachos, 1990).

Shqipëria është një ndër vendet më sizmoaktivë në Evropë. Epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M \leq 5.0$), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Përgjithësisht tërmetet e Shqipërisë dhe rajoneve përreth kanë vatra të cekta, thellësia e të cilave shkon nga 10-25 km.

Në llogaritjet e rrezikut sizmik për truall shkëmbor, shpejtimi (akseleracioni) maksimal I truallit - PGA si dhe shpejtimet spektrale - SA për shuarje 5 % përcaktohen për dy perioda të përsëritjes të tërmeteve: 475 e 95 vjet, për të cilat ndërtohen edhe hartat përkatëse të rrezikut sizmik. Bazuar në këtë metodikë është bërë edhe vlerësimi i rrezikut sizmik të territorit të Bashkisë të Përmetit që paraqitet në vijim (Tabela 5 dhe Figura 19).




Figura 19. Harta e shpejtimit spektral SA (0.2) me shuarje 5% në truall shkëmbor dhe probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periodë përsëritje 475 (Majtas) dhe Harta e Rrezikut Sizmik në Shqipëri (Djathtas) (Burimi: Aliaj et al. 2010).

Këto vlera të parametrave të rrezikut sizmik kanë rëndësi praktike për ndërtimet në secilën Njësi Administrative të Bashkisë Përmet, sepse:

1. Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit - PGA dhe të shpejtimit spektral - SA për perioda 0.2-0.5 sekonda u korespondojnë energjisë periudhë-shkurtër, e cila do të ketë efektin më të madh mbi strukturat periudhë-shkurtër, në ndërtimet deri afër 7 kate të lartë, ndërtimet më të zakonshme sot.
2. Hartat e shpejtimit spektral periudhë-gjatë: 1.0 sek., 2.0 sek. etj. paraqesin nivelin e lëkundjes të truallit që do të ketë efektin më të madh në strukturat më periudhë-gjata, në ndërtimet 10 kate të lartë e me tepër, në urat etj.
3. Duke qenë se rreziku sizmik është llogaritur për truall shkëmbor, për ndërtimet në truall shkëmbor duhet eliminuar pjesa e sipërme rreth 5-6 m e depozitimeve të shkrifta deluvialoeluviale që mbulojnë shkëmbijtë rrënjësorë. Ndërsa për ndërtimet në troje të butë, mbi depozitimet Kuaternare (Holocene), kërkohet kryerja më parë e studimeve gjeologjinxhinierike për saktësimin e modelit gjeoteknik dhe mandej vlerësimi i rrezikut sizmik për çdo zonë që do t'i nënshtrohet zhvillimit të ri perspektiv.

Tabela 5. Vlerat e rrezikut sizmik (PGA dhe SA (g)) për Bashkinë Përmet me probabilitet 10% /10 vjet (me periudë përsëritje 95 vjet) dhe probabilitet 10%/50 vjet (me periudë përsëritje 475 vjet), nëtrual shkëmbor.

| Njesia Admin. | Koordinatat | | Probabiliteti | PGA 0.01 s | SA | | | |
|-----------------------|-------------|-------|------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| | V | L | | | 0.2 s | 0.5 s | 1.0 s | 2.0 s |
| Çarçovë | 40.11 | 20.55 | 10%/10 10%/50 | 0.102 0.201 | 0.221 0.459 | 0.121 0.206 | 0.060 0.132 | 0.026 0.059 |
| Frashër | 40.37 | 20.43 | 10%/10 10%/50 | 0.087 0.148 | 0.211 0.385 | 0.115 0.223 | 0.057 0.114 | 0.026 0.054 |
| Petran | 40.21 | 20.40 | 10%/10 10%/50 | 0.095 0.181 | 0.224 0.448 | 0.119 0.250 | 0.059 0.126 | 0.026 0.057 |
| Përmet | 40.23 | 20.31 | 10%/10 10%/50 | 0.098 0.210 | 0.233 0.497 | 0.122 0.271 | 0.061 0.135 | 0.027 0.060 |
| Qendër Piskovë | 40.28 | 20.27 | 10%/10 10%/50 | 0.099 0.182 | 0.22 0.441 | 0.118 0.247 | 0.059 0.126 | 0.026 0.057 |

Mbështetur në hartën e rajonizimit sizmik të Shqipërisë, Bashkia e Përmetit ka intensitetin e pritshëm sizmik për kushte mesatare trualli $I_0 = 6$ ballë MSK-64 (Figura 19).

IV. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE NË MJEDIS, TË PROJEKTIT

4.1. METODOLOGJIA PËR IDENTIFIKIMIN DHE ANALIZËN E NDIKIMEVE

Përshkrimi i një ndikimi të mundshëm përfshin një vlerësim të karakteristikave të tij, së bashku me atributet e mjedisit pritës. Karakteristikat perkatese të ndikimit përfshijne nëse ndikimi është:

- ✚ Negativ apo i dobishëm;
- ✚ I drejtpërdrejtë ose i tërthortë;
- ✚ Afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë në kohëzgjatje; dhe i përhershëm ose i përkohshëm;
- ✚ Me ndikim në shkallë lokale, rajonale ose globale; përfshirë edhe ndikimin ndërkufitar; dhe
- ✚ Kumulative (Një ndikim kumulativ është "ndikimi në mjedis që rezulton nga rritja e ndikimit të një veprimit, kur shtohet mbi veprime të tjera të ndodhura në të kaluarën, tashmen apo dhe të veprimeve të arsyeshme të parashikuara të ndodhin në të ardhmen").

Secila nga këto karakteristika është diskutuar për çdo ndikim. Marrja në konsideratë e treguesve të mësipërm jep një ndjenjë të intensitetit relativ të ndikimit. Ndjeshmëria e mjedisit pritës u përcaktua nga specialistët bazuar në të dhënat bazë të mbledhura gjatë studimit.

Çdo ndikim është vlerësuar duke përdorur kriteret e renditura në Tabelën 6. Për të siguruar një ilustrim relativ shkalle së ndikimit, është e dobishme që të caktohen përshkrues numerike ose relativë të intensitetit të ndikimit dhe ndjeshmëria e receptorit për çdo ndikim të mundshëm. Secili kriter është vlerësuar në një shkallëzim numerik 1, 2, 3, ose 4, që korrespondon me nivelet: shumë të ulët, të ulët, të mesëm ose të lartë. Shkalla (ashpërsia) e ndikimit është llogaritur më pas si produkti i dy përshkruesve numerike, duke e përshkruar shkallen (ashpërsinë) e ndikimit si të papërfillshme, të vogël, të moderuar apo të madhe. Kjo është një metodë cilësore e projektuar për të siguruar një renditje të gjerë të ndikimeve të ndryshme të një projekti. Në Tabelën 7 janë dhënë ilustrime të llojeve të ndikimit që marrin vlera të ndryshme të ashpërsisë.

Tabela 6. Klasifikimi i vleresimit te ndikimeve ne mjedis

| | Klasifikimi | Përshkrimi |
|---|--|---|
| 1 | Shtrirja: | Vlerësimi i zonës së shfaqjes/influences të ndikimit mbi mjedisin ne fjale; nëse ndikimi do të ndodhë në vend, në një zonë të kufizuar (brenda nje rrezeje prej 2 km nga vendi i projektit); në nivel lokal (brenda nje rrezeje prej 5 km); rajonal (nivel qarku, kombëtar ose ndërkombëtar). |
| 2 | Vazhdimësia/ Kohezgjatja: | Vlerësimi i kohëzgjatjes së ndikimit në mjedis, nëse ndikimi ka qenë i përkohshëm (<1 vit); afat-shkurtër (1 - 5 vjet); afat-mesëm (5 - 10 vjet); afatgjatë (> 10); ose i përhershëm. |
| 3 | Konteksti social / Ndjeshmeria ose Potenciali për konflikt ndermjet aktorëve: | Vlerësimi i ndikimeve për receptorët e ndjeshëm në aspektin e ndjeshmërisë ekologjike, sociale dhe aspekteve të tilla si specie të rralla dhe të rrezikuara, mjedise sensitive ekologjike dhe të rrezikuara, arkitekturë, mjedis shoqëror ose kulturor, potencial i madh për konflikte interesash te aktoreve te ndryshem. Klasifikimi i ndjeshmërisë është paraqitur më poshtë: <i>Ndjeshmëri e larte:</i> Zhvendosje e gjithë komunitetit, shkatërrim i trashëgimisë botërore apo vendeve të rëndësishme kulturore, konflikt në shkallë të madhe të grupeve të interesit, etj <i>Ndjeshmëri Mesatare:</i> Zhvendosja e disa familjeve, niveli i moderuar i shqetësimit të palëve të interesuara <i>Ndjeshmëri e ulët:</i> Nuk jane te nevojshme zhvendosjet, nuk ka potencial për konflikt të palëve të interesuara. |
| 4 | Pajtueshmëria me kerkesat ligjore dhe kuadrin rregullator | Vlerësimi i ndikimit ndaj kërkesave ligjore kombetare dhe ndërkombëtare. <i>E lartë:</i> Shkelje të mëdha të kërkesave rregullative që mund të rezultojnë në ndjekje penale ose vonesa të mëdha në miratimin e projektit. <i>Mesatare:</i> Shkelje potenciale te kufijve specifike te kuadrin rregullator që mund te rezultojë në mospërputhje. <i>E ulet:</i> Nuk parashikohen shkelje të kufijve të veçantë të kuadrin rregullator. |
| 5 | Vlerësimi i Ndikimit në përgjithësi (Rëndësia): | Duke përdorur një kombinim të kriterëve të mësipërme, rëndësia e përgjithshme e ndikimit është kategorizuar si: shumë e madhe, e moderuar, e vogël dhe e papërfillshme. Referojuni Tabelës 7 për kategoritë specifike të ndikimit për secilin vlerësim. |

Shënim: Këto janë vetëm udhëzime që do të përbëjnë gjykimin profesional qe kërkohet në çdo rast individual.

Rëndësia e ndikimit është përcaktuar nepërmjet nje matrice të rëndësise se ndikimit (Tabela 7) e cila krahason peshën e ndikimit me probabilitetin e ndodhjes së tij. Kriteret e rëndësisë se ndikimit janë si më poshtë:

- ✚ *Shumë i Lartë (VH) dhe i lartë (H)*: Këto tregojne se ndikimi është i papranueshëm dhe se duhet të zbatohen masa të tjera zbutëse për të zvogëluar rëndësinë. E ngjyrosur me ngjyrë të kuqe në tabelën 7.
- ✚ *Mesatare (M)*: Ndikimet në këtë rajon konsiderohen të tolerueshme por duhet të bëhen përpjekje për të reduktuar ndikimin në nivele që janë aq të ulëta sa gjykohen si praktikisht të arsyeshme. E ngjyrosur me ngjyrë të verdhë në matricën e rëndësisë së ndikimit.
- ✚ *E ulët (L)*: Ndikimet në këtë rajon janë konsideruar të pranueshme. E ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër.

Tabela 7. Percaktimi i rëndësisë së ndikimit

| | | | Ndjeshmeria e receptorit | | | |
|------------------------|--------------|---|--------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| | | | Shumë e ulët | E ulët | Mesatare | E lartë |
| | | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| Intensiteti i ndikimit | Shumë e ulët | 1 | 1 I papërfillshëm | 2 I vogël | 3 I vogël | 4 I vogël |
| | E ulët | 2 | 2 I vogël | 4 I vogël | 6 I moderuar | 8 I moderuar |
| | Mesatare | 3 | 3 I vogël | 6 I moderuar | 9 I moderuar | 12 I madh |
| | E lartë | 4 | 4 I vogël | 8 I moderuar | 12 I madh | 16 I madh |

Efektet kumulative vihen re kur kushtet socio-mjedisore janë tashmë ndikuar nga zhvillimet e kaluara ose me shumë të ngjarë do të ndikohen nga zhvillime apo aktivitete që është e mundshme të zhvillohen në të ardhmen. Në këtë VNM janë identifikuar aktivitete të së kaluarës, aktuale, dhe aktivitete të ngjashme që mund të komplikojnë kushtet socio-mjedisore në zonën e projektit.

Masat zbutëse janë planifikuar për të shmangur, reduktuar, zbutur apo kompensuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale dhe janë pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM).

V. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE NË MJEDIS

5.1. NDIKIMET GJATE FAZES SE ZBATIMIT/NDERTIMIT

5.1.1. Ndikimi Social

Të ardhura më të larta për kontraktorët dhe për furnitorët e materialeve: Zhvillimi i projektit nënkupton punimet civile që kërkojnë materiale të tilla si zhavorr, pllaka, lëndë druri, hekur dhe çimento. Ky ndikim është pozitiv, por afatshkurtër dhe ndikimi i kthyeshëm. Duke pasur parasysh se puna ndërtimore do të jetë lokale apo kombëtare, ky ndikim ka shtrirje lokale apo kombëtare.

Masat përmirësuese: Lëndët e para (materialet e ndërtimit) duhet të merren vetëm nga subjekte të licensuara. Materialet e ndërtimit të cilat do të përdoren, do të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Blerja e vetëdijshme ose i paqëllimtë e këtyre materialeve nga operatorë të palicencuar në mënyrë indirekte nxit degradimin e mjedisit në zonat ku janë vendosur këto subjekte të paligjshme dhe mund të shpjerë në ndikime negative afatmesme apo afatgjata. Prandaj, blerja e materialeve të ndërtimit nga guroret e licencuara dhe që operojnë në mënyrë legjitime duhet të jetë një detyrim kontraktual për kontraktorët.

Punesimi: Ndërtimi do të ofrojë mundësi si të punonjesit e kualifikuar ashtu edhe për fuqi punëtore të pakualifikuar. Ky do të jetë një ndikim pozitiv, por afatshkurtër dhe i kthyeshëm, që zgjat vetëm gjatë periudhës së ndërtimit (implementimit të projektit).

Masat përmirësuese: Kurdo që të jetë e mundur, duhet të konsiderohet mundësia e punësimit e banorëve lokale, kjo në varësi të nivelit të aftësive të tyre. Për të siguruar një mjedis të favorshëm për punën është e domosdoshme që për punonjesit të ofrohen standardet perkatëse të shëndetit dhe sigurisë në punë.

5.1.2. Ndikimet fizike me ndryshime në topografinë lokale

Identifikimi i ndikimit: Zbatimi i këtij projekti do të përfshijë aktivitete të ndryshme. Gjate kësaj faze nuk do të ketë ndryshime të mëdha në topografinë lokale pasi në përgjithësi sheshi ka pjerresi të ulët. Në projekt është parashikuar një radhe dhe drejtim i tillë organizimi, që në kombinim me masat e tjera suplementare si të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë ndryshime topografike. Përsa i përket ndikimeve nga efekti i erozionit, zona nuk është e predispozuar ndaj erozionit në sipërfaqe, i cili është në nivele të paperfillshme. Ky fenomen mund të haset gjatë germimit të

dheut për ndërtimin e themeleve. Për të parandaluar këto fenomene (në raste se e hasim gjatë germimit të dheut) duhen marrim masa në mënyrë që të sigurohen të gjithë veprimet e nevojshme që janë parashikuar për të siguruar qëndrueshmërinë e objekteve përreth.

5.1.3. Dëmtimi i Habitave dhe Biodiversitetit

Ekologjia tokësore dhe biodiversiteti mund të ndikohen gjatë përgatitjes së sheshit të projektit si edhe aktiviteteve të ndërtimit dhe operimit. Mund të preket gjithashtu nga shfaqja e ngjarjeve jo rutinore. Ndikimet mund të vijnë nga aspektet e mëposhtme mjedisore:

- Transporti dhe përdorimi i pajisjeve;
- Gërmime dhe punime tokësore për ndërtim;
- Hedhja e mbeturinave gjatë ndërtimit dhe operimit;
- Ngjarje aksidentale (jo-rutinore): derdhje dhe rrjedhje e vajrave dhe naftes;
- Ngjarje aksidentale (jo-rutinore): asgjësim i papërshtatshëm i mbeturinave

Gjatë fazës së zbatimit të projektit mund të ketë sipërfaqe të kufizuara që mund të zhvishen/pastrohen nga vegetacioni. Por këto do të rigjellbërohen me drure apo shkurre të tjera sikurse tregohet në Figurën 20. Përpos kësaj, në përfundim të projektit janë planifikuar të mbillen edhe shumë drure të tjera, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në balancën e nivelit të CO₂ në atmosferë.

Gjatë fazës operative, aktivitetet në zonën e projektit do të çojnë në një rritje të mbeturinave dhe mbetjeve të ngurta. Mbetjet e ngurta, të krijuara nga aktivitetet e funksionimit, mund të ndikojnë negativisht në një numër të KVE- (Komponentëve më me Vlerë të Ekosistemit), përfshirë gjitarët dhe bimësinë.

Ngjarjet aksidentale gjatë ndërtimit dhe funksionimit të projektit mund të përfshijnë zjarret, derdhje të karburantit, etj. Planet e reagimit emergjent do të jenë në vend për të lehtësuar çdo ngjarje aksidentale.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Për humbjen e habitatit si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit nuk ka asnjë masë specifike; megjithatë, ripopullimi ka të ngjarë të ndodhë në zonat që nuk i nënshtrohen shqetësimeve të vazhdueshme të lidhura me funksionimin e zonës së projektit.
- ii) Pastrimi i përgjithshëm duhet të jetë i vazhdueshëm për të parandaluar krijimin e pirgjeve me mbeturina apo që mbeturinat që lidhen me aktivitetet në zonën e projektit të përhapen në të gjithë zonën dhe zonën ngjitur.

- iii) Kur është e mundur, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin tek gjiatët dhe zogjtë.
- iv) Përdorimi i bimëve vendase për peizazhet përgjatë korridoreve duhet të ketë perparësi ndaj llojeve të indroduktuara.
- v) Automjetet dhe pajisjet duhet të mirëmbahen për të minimizuar emetimet dhe rrjedhjet e panevojshme.
- vi) Për të minimizuar shkatërrimin e habitatit nga udhëtimet jashtë trupit të rrugës duhet të përdoren rrugët dhe gjurmët ekzistuese.

5.1.4. Gjenerimi i mbetjeve inerte

Identifikimi i ndikimit: Projekti për zhvillimin e integruar urban dhe të turizmit në qytetin e Përmetit, do të përfshijë disa aktivitete që mund të gjenerojnë mbetje inerte të konsiderueshme të përbërë nga tulla, blloqe betoni, metale, qelq dhe mbeturina druri. Ketu përfshihen punimet për:

- heqjen dhe rivendosjen e kalldrëmave ekzistues
- heqjen e shtesave, siç janë rrethimet dhe portat me materiale të papërshtatshme (të tilla si mbetje industriale);
- pajisjen sipas nevojës me kanalizime përgjatë rrugicave duke përfshirë edhe lidhjet me ndërtesat ekzistuese;
- heqjen dhe rivendosjen në kanale nëntokësore e kabllave ajrore ekzistuese përgjatë rrugicave;
- vendosjen e sistemit të ri të ndriçimit me ndriçues të përshtatshëm në mënyrë që të evidentohen ndërtesat specifike/ monumentet dhe të përmirësohet në përgjithësi aksesimi pamor dhe aksesimi fizik i zonës;
- rihvillimin e dy shesheve, duke përdorur si material shtrimi të njëjtin material që kanë hapësirat publike ekzistuese të lëna pas dore;
- rikonstruktimin e dy urave automobilistike me një sens lëvizjeje dhe një trotuar për këmbësorë.
- sistemimin e çezmave antike
- riprofilizimin të seksionit të rrugës, duke rikonstruktuar trotuarët, parkimin në rrugë.
- krijimin e një rruge biçikletash, nga sheshi kryesor deri në fund të rrugës Kongresi i Përmetit, përtej Sallës së Kongresit, rreth 420 m gjatë

Vlerësimi i ndikimit: Trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ndërtimit mund të ketë ndikime në mjedis dhe shëndetin publik. Hidrologjia e ujërave sipërfaqesore mund të preken gjatë prishjes së kalldrimeve nëpërmjet gërryerjeve të materialeve të imta të gjeneruara si rezultat i pastrimit të mbetjeve dhe sipërfaqes të tokës të ekspozuar ndaj shiut dhe kullimit të ujërave. Këto mund të depozitohen në rrjedhat e ujit dhe ndryshojnë natyrën e shtratit të përrrenjve.

CFL (llambat fluoeshente kompakte) do të zëvendësohen me llambat LED (Light Emitting Diode). Llambat CFL që do të hiqen, përmbajnë merkur (Hg), i cili klasifikohet si mbetje e rrezikshme, sipas ligjit shqiptar. Më konkretisht merkuri është renditur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 99, "Për miratimin e katalogut shqiptar për klasifikimin e mbeturinave":

05 07 01 * që përmban mbeturinat e merkurit (Hg) dhe 17 09 01 * Mbeturinat e ndërtimit dhe shkatërrimit që përmbajnë merkur. Megjithatë, numri i llambave CFL që do të zhvendoset është relativisht i vogël.

Si masë zbutëse, rekomandohet që llambat të cilat janë akoma funksionale të grumbullohen dhe të përdoren nga Bashkia në vende të tjera, kurse për ato që nuk janë funksionale, duhet që në dokumentet e Tenderit të specifikohet që kontraktuesi të krijojë kontakte me kompanitë e riciklimit që marrin merkur për riciklim.

Rëndësia e ndikimit: largimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ndërtimit mund të ketë ndikime afat-mesme apo afatgjatë në mjedis dhe shëndetin publik. Shtrirja e këtij ndikimi do të jetë lokale në zonat ku do të hidhen mbetjet, apo në lagjet në afërsi. Mundësia që ky ndikim të ndodhi është *E lartë* duke patur parasysh mungesën e objekteve që trajtojnë mbetjet e ndërtimit. Nëse hidhen në vende të papërshtatshme mbetjet e ndërtimit ndotin burimet mjedisore (tokën dhe ujin) apo shkaktojnë efekte në shëndetin publik, ndaj edhe rëndësia e këtij ndikimi do të jetë *E lartë*.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Kontraktorët duhet të bëjnë kategorizimin e mbetjeve në burim për të ndarë mbetjet e rrezikshme nga ato të pa rrezikshme;
- ii) Përcaktimi i rrugës dhe kohës së qarkullimit të kamionëve të rëndë që transportojnë mbeturinat nga shembja e godinës në mënyrë që të shmangen zonat e banuara ose receptorë të tjerë të ndjeshëm njerëzorë sa më shumë të jetë e mundur
- iii) mbetjet duhet të largohen nga sheshi të paktën një herë në 24 orë dhe kur mbahen përkohësisht në vend duhet të mbulohen për të minimizuar aromën e pakëndshme dhe parazitët.

- iv) Kontraktori do të punojë së bashku me Bashkinë për të lehtësuar trajtimin e duhur dhe asgjësimin e mbeturinave nga sheshi. Të gjitha mbetjet duhet të hidhen në deponitë e miratuara.
- v) Mbeturinat e rrezikshme të tilla si bojerat, çimento, adhezivët do të menaxhohen përmes një pale të tretë (kontraktor) të certifikuar nga AKM-ja. Bashkia dhe kontraktori do të punojnë së bashku për të lehtësuar trajtimin e sigurtë dhe asgjësimin e mbeturinave nga sheshi.
- vi) inxhinierët mbikëqyres (supervizori) dhe inspektorët e agjensisë rajonale të mjedisore duhet të sigurohen se kontraktuesit nuk i hedhin mbetjet në mënyrë të paligjshme në zonat të tjera jashtë atyre të caktuara. Inspektorët e mjedisit nga ARM duhet të ndërmarrin rolin aktiv për monitorimin gjatë periudhës së ndërtimit.
- vii) duhet të krijohet dhe të zbatohet mekanizmi i ankesave për të adresuar shqetësimet dhe ankesat mundshme nga komuniteti.

5.1.5. Ndikimet e mundshme në peisazh dhe anën vizuale














Fokusi i vlerësimit të ndikimit në peisazh dhe në pamjen vizuale të zonës të projektit kanë qenë: efektet e vecanta në modelin e përgjithshëm të elementeve të peisazhit që krijojnë karakterin e peisazhit dhe dallueshmërinë lokale dhe rajonale; apo zonat me interes ose vlera të veçanta siç janë zonat me domethënie të veçantë peisazhi p.sh. "genius loci".

Në fazën e ndërtimit do të lined nevoja për vendosjen e materialeve, pajisjeve apo dhe kordonëve për rrethimin e sheshit të ndërtimit. Meqenëse ansambli historik do të mbetet i hapur për qasje nga komuniteti lokal, prania e këtyre aktiviteteve dhe materialeve të tyre do të shkaktojë një impakt negativ të përkohshëm vizual në vendin e ndërtimit. Prania e aktiviteteve të ndërtimit do të ndryshojë edhe imazhin rreth pamjes vizuale me të cilën jemi mësuar.

Projekti do të ketë një ndikim shumë pozitiv në peisazh dhe anën vizuale me trajtimin dhe riparimin e të gjitha shtigjeve të lagjes së vjetër historike me kalldrëm; krijimin e një zone bufferike të peisazhit rreth kanalit (parku linear); duke shtruar shtigjet në hapësirat e gjelbërta me gurë të zonës; mbjellja e luleve (trëndafilave) tipikë të Përmetit, mbjellja e pemëve të reja dhe në disa raste, rimbjellja e pemëve ekzistuese (të mbjella kohët e fundit), për shkak të zhvendosjen e tyre përgjatë trotuarëve anësore të rikonstruktuar.

Tabela 10 tregon një listë të drureve eksistues, atyre që do të zhvendosen dhe drureve ose shkrurreve që do të mbillen të reja dhe që do të shtohen listës së atyre eksistuese me karakteristikat përkatëse.

Tabela 8: Druret eksistues, druret qe do te zhvendosen dhe ato qe do te mbillen

| Existing and proposed greenery in Permet | | | | |
|---|--|--|--|--|
| Tree | Botanical name | Crown diameter | Characteristics | Notes |
|  | Pemë ekzistuese / Existing trees | Varion/Various | Varion/Various | Licjet dhe tipet e pemëve ekzistuese që do të mbeten dhe nuk do të ndryshojnë / Type of existing trees that will remain and not be displaced |
|  | Pemë që do të çrënjosen / Trees that will be uprooted | Varion/Various | Varion/Various | 8 pemë do të çrënjosen për shkak se duhet arritur unifikimi i zonës ose në rastet kur pengon kanalizimet ose ndërcimin për tu rimbjellë sërish / 8 trees will be uprooted because must be achieved the unification of the area or when they are an obstacle for water canalisations and lightning they will be rooted again |
|  | Pemë që do të priten / Trees to be cut | Varion, me shume se 6 m/Various, more than 6 m | Kurorë e dëndur, mife e shpejtë. Gjetherenes / Fast-Growing and Short-Lived Deciduous Tree. | 15 pemë që do të priten për shkak të gjendjes së keqe të tyre / 15 trees to be cut down because of their poor condition |
|  | Acer negundo – Box Elder, Boxelder Maple, Ash-Leaf Maple | Varion, me shume se 6 m/Various, more than 6 m | Kurorë e dëndur, mife e shpejtë. Gjetherenes / Fast-Growing and Short-Lived Deciduous Tree. | 42 pemë janë ekzistuese dhe do të shtohet 1 pemë e re në të njëjtin lloj, sipas planit arkitektonik / 42 remaining existing trees and 1 new tree added to the same species, according to the architectural project. |
|  | Prunus cerasifera "Pissardi"/Kumbull e kuqe | Varion, me shume se 6 m/Various, more than 6 m | "Pissardi" është një pemë e drojtë, e rumbullakosur dhe e dyfishhtë, me gjethe shumë të errëta të kuqe-vjollçë. / "Pissardi" is an upright, rounded, twiggy tree with very dark red-purple leaves. | 11 pemë të reja dhe 6 pemë që zhvendosen nga rruga "Tomor Mullaraj" tek rruga "13 Shtatori", sipas planit arkitektonik/ 11 new trees and 6 trees shifting from "Tomor Mullaraj" street to "13 Shtatori" street, according to the architectural project. |
|  | Querus ilex - Dru ilçe | Varion, me shume se 6 m/Various, more than 6 m | Kurorë e dëndur, mife e shpejtë. Gjetherenes / Fast-Growing and Deciduous Tree. | Ekzistuese janë 80 pemë dhe do të shtohen edhe 6 të tjera të cilat do të vendosen në rruget "Sami Frashëri" dhe "Tomor Mullaraj", sipas planit arkitektonik./ There are 80 existing trees and will be added 6 more to be placed at "Sami Frashëri" and "Tomor Mullaraj" street, according to the architectural project. |
|  | Cypress/ Qiparis | Varion/Various | Pema e qiparisit është mjaft e madhe, tipike mbi 30 m e gjatë. Kurora e pemës është në formë kon dhe në bazë./ The cypress tree is quite large, typically over 30 m tall. The crown of the tree is cone-shaped and at the base. | 5 qiparisa ekzistues, nga të cilat 4 prej tyre do të behet ndërcim artistik, sipas planit arkitektonik/ 5 existing cypresses tree, 4 of them will be artistically lighted, according to the architectural project. |
|  | Tilia Cordata | Varion, me shume se 2 m/Various, more than 2 m | Kurorë e dëndur, mife e shpejtë. Gjetherenes / Fast-Growing and Short-Lived Deciduous Tree. | 142 pemë gjithsej në rruget "Meleq Gosnishi" dhe "Kongresi i Permetit" nga të cilat 135 janë ekzistuese dhe shtojme 7 pemë të reja, sipas planit arkitektonik./ There are 142 trees in the street "Meleq Gosnishi" and "Kongresi i Permetit" of which 135 are existing and we add 7 new trees, according to the architectural project. |
|  | Acacia | Varion, 5-8 m/Various, 5-8 m | Akaciet janë pemë të këndshme që rriten në klima të ngrohta. Gjetja është zakonisht jeshile e ndritshme. Acacia mund të jetë me gjeberim të perjeshëm ose gjetherenese./Acacias are graceful trees that grow in warm climates. The foliage is typically bright green. Acacia may be evergreen or deciduous. | 25 pemë acacia do të mbillen përgjatë Perroit të Bardhë, sipas projektit arkitektonik./25 acacia trees will be planted along the Perroi i Bardhë, according to the architectural project. |
|  | Vreshtari/Viticulture | Varion/Various | Hardhija është një bimë me aftësi ngjitje. Në përgjithësi ka një shtytje vegetative të fortë në pjesën e parë të sezonit, kur temperaturat dhe disponueshmëria e ujit nuk janë të limituara. The vine is a plant with climbing ability. Generally there is a strong vegetative thrust in the first part of the season, when temperatures and water availability are not limited. | Do të vendosen në hyrje të rrugës "e Avdiut", mbështetur në struktura metalike, sipas planit arkitektonik./Will be placed at the entrance of "e Avdiut" street, according to the architectural project. |
|  | Trendafil i eger/ Rosa Madame Alfred Carriero | Varion/Various | Lulet rozë të kësaj kaçube ngjitesë janë të hapura për trëndafilin të dyfishhtë ngjyrash me aromë të ëmbël. Ndërsa lufja përqet ajo bëhet plotësisht e bardhë./ The pink buds of this climbing shrub open to sweetly-scented double buff color roses. As the flower matures it becomes completely buff white. | 30 rrenje të reja trendafilash të eger të cilat do të vendosen anë portave, sipas planit arkitektonik./30 new roses which will be placed by the gates, according to the architectural project. |
|  | Pyrostegia venusta | Varion/Various | Kaskada me lule portokalli. Zakonisht rritet në zona tropikale dhe subtropikale, si dhe në klimat e buta mesdhetare. Bimët formojnë një masë të dendur, në mura ose mbi shkëmbinj dhe mbulojnë me lule në sezonin e ftohtë dhe të thatë./Cascades of orange flowers. It is grown in tropical and subtropical areas, as well as in mild Mediterranean climates. The plants form dense masses, on walls or over rocks, and are covered with flowers in the cool, dry season. | 26 rrenje të reja Pyrostegia të cilat do të vendosen anë portave, sipas planit arkitektonik./26 new Pyrostegia which will be placed by the gates, according to the architectural project. |
|  | Gjeberim i ulët Green space | Varion/Various | | |

Ne rrugen “Elena Gjika” pervec 80 drureve eksistues do te mbillen edhe 6 drure te tjere sikurse edhe 30 rrenje trendafilash te cilat do te vendosen prane portave te drurit ne perputhje me planin arkitektonik (Figura 52), ndersa 8

drure te tjere qe nuk perputhem me planin do te zhvendosen dhe do te mbillen diku tjeter ne nje vend te caktuar nga Bashkia.

2. Ne rrugen "Kongresi i Përmetit": 135 drureve eksistues do ti shtohen edhe 7 drure te tjere Bliri flete-argjente(*Tilia cordata*) sikurse edhe 25 drure acacia (*Robinia pseudoacacia*) dhe disa rrenje hardhi (Figure 53). Ndersa 8 drure te tjere qe nuk perputhem me planin do te zhvendosen dhe do te mbillen diku tjeter ne nje vend te caktuar nga Bashkia..

3. Ne rrugen "Meleq Gosnishti": drureve eksistues do ti shtohen edhe 11 drure te tjere. Ndersa 6 drure te tjere do te zhvendosen nga rruga "Tomor Mullaraj" ne rrugen "13 Shtatori" ne perputhje me planin arkitektonik (Figure 54).

Punimet per sistemimin e peizazhit do të krijojnë pajtueshmëri më të mirë vizuale mes elementeve te ndryshem te peisazhit te zones se projektit dhe rrethinave p.sh. masa, lartësia, forma, proporcioni dhe ritmet e elementeve të ndërtimit, ngjyra dhe materiali i përdorur. Nuk do të lejohet asnjë pengesë vizuale p.sh. bllokimi i pamjeve drejt tipareve ekzistuese të peizazhit; ose korridoreve ekzistuese.

Kohëzgjatja e ndikimit vizual do të jetë *afatshkurtër* vetëm në fazën e ndërtimit. Intensiteti i ndikimit do të jetë shumë i ulët duke marrë parasysh gjendjen e shkatërruar të shumicës së objekteve ekzistuese; prandaj ndjeshmëria ndaj receptorëve do të jetë *e ulët*, pra rëndësia e ndikimit *është e vogël*.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

Kontraktuesi duhet të sigurojë qe gjurma e lenë nga aktivitetet e ndërtimit të jetë minimale.



Figura 21. Qyteti Modern: Plani i Gjellbërimit – rruga “Elena Gjika”




Figura 22. Qyteti Modern: Plani i Gjelbërimit – rruga “Meleq Gosnishti”




Figura 23. Qyteti Modern: Plani i Gjellbërimit – rruga “Sami Frasheri”

5.1.6. Presioni mbi burimet (lëndët e para) ekzistuese

Gjatë fazës së ndërtimit, kërkesa për lëndet e para baze të tilla si uji dhe energjia elektrike mund të ushtrojë presion mbi infrastrukturën ekzistuese.

Duke pasur parasysh natyrën e projektit, *intensiteti i ndikimit* do të ketë *I ulët* dhe afat-shkurtër dhe i kufizuar vetëm gjatë fazes së ndërtimit. Megjithatë, ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë *E lartë*, duke dhënë një ndikim me rëndësi të moderuar.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

Kontraktuesi duhet të sigurojë vend (depozitë) të veçantë për ujin që do të përdoret në ndërtim. Në vend që të lidhet me sistemin e furnizimit me ujë të zonës, kontraktori duhet të zgjedhi të përdorë ujë nga depozitat për furnizimin me ujë.

5.1.7. Gjenerimi i Zhurmave dhe Vibrimeve

Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga përdorimi i fadronave, gjeneratoreve, matrapikeve, zhurma e prodhuar nga vetë personat që do të punojnë në ato shesh, proceset e hedhjes së betonit, përdorimi i skelave dhe derrasave, pajisjeve të prerjes së hekurit, etj. Punëtorët që mund të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit. Kjo duhet të kihet parasysh nga drejtuesi teknik i punimeve. Nuk do të shkaktohen vibrime shqetesuese gjatë punimeve. Për të reduktuar këtë ndikim, subjekti ndërtues, nuk duhet të punojë gjatë orëve të vona ku niveli i lejuar i zhurmave është më i ulët. Tabela në vijim (Tabela 19) paraqet nivelin e zhurmës të krijuar nga disa automjete dhe makineri, të cilat përdoren rëndom në punimet e ndërtimit.

Tabela 9. Nivelet e zhurmës të emetuara nga makineritë më të përdorshme në ndërtim [në dB(A)]

| PASTRIMI | | NDËRTIMI I STRUKTURAVE | |
|---------------------------------------|-------|---------------------------------------|-------|
| Buldozer | 80 | Vinç | 75-77 |
| Fadromë me kovë me ngritje automatike | 72-84 | Gjenerator mono/dy/trefazë saldimi | 71-82 |
| Matrapik | 81-98 | Përzierës betoni | 74-88 |
| Vinç Kullë i lëvizshëm | 75-87 | Pompë Betoni | 81-84 |

| | | | |
|---------------------------------------|-------|---------------------------------------|-------|
| | | Vibrator betoni | 76 |
| GËRMIMI DHE ZHVENDOSJA E DHERAVE | | Kompresor ajri | 74-87 |
| Buldozer | 80 | Çekiçe pneumatic | 81-98 |
| Eskavator | 72-93 | Buldozer | 80 |
| Fadromë me kovë me ngritje automatike | 72-84 | Betoniere me pompë | 83-94 |
| Kamion Vetshkarkues | 83-94 | Fadromë me kovë me ngritje automatike | 72-84 |
| Matrapikë | 81-98 | Kamion Vetshkarkues | 83-94 |
| Skraper | 80-93 | Makineri shtruese pllakash betoni | 86-88 |
| NIVELIMI DHE KOMPAKTËSIMI | | PEISAZHET DHE PASTRIMI | |
| Makineri Sheshimi/Nivelimi | 80-93 | Buldozer | 80 |
| Rrul | 73-75 | Eskavator | 72-93 |
| Makineri shtruese pllakash betoni | 86-88 | Kamion | 83-94 |
| | | Fadromë me kovë me ngritje automatike | 72-84 |

(Burimi: U.S. Environmental Protection Agency. Noise from Construction Equipment and Operations. Building Equipment and Home Appliances)

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes. Zhurma operationale është e lidhur me funksionimin. Gjatë funksionimit nuk ka burime potenciale të zhurmave pasi përdorimi normal i këtyre objekteve të rikualifikuara nuk rezulton që mund të shpjegojë në rritje nivelin e zhurmës. Në rast të verpimitarive që gjenerojnë duhet të merren masa të përshtatshme për minimizimin e tyre për të cilat ka mundësi të shumta e përvoja të njohura për t'u zbatuar.

Reagimi i njerëzve ndaj vibracioneve në terren ndikohet nga shumë faktorë fizike, si amplituda, kohëzgjatja dhe përmbajtja e frekuencave të vibracioneve, si dhe faktorë të tjerë si lloji i popullsisë, mosha, gjinia dhe pritjet të cilat janë fiziologjike. Në këto mënyra reagimi i njerëzve për vibracionet është subjektiv dhe kjo ndryshon për njerëz të ndryshëm. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet e dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Tabela në vijim (Tabela 10) paraqet distancat në të cilën dridhjet mund të jetë të dukshme për lloj të caktuar të aktivitetit të

ndërtimit. Këto shifra janë të bazuara në matjet historike në terren dhe nga literatura. Të vetmet burime të vibrimit që të merret në konsideratë do të jenë kamionë të rëndë gjatë qarkullimit në objekt.

Tabela 10. Aktivitetet e ndërtimit dhe ndikimi i vibrimeve

| Aktivitetet e ndërtimit | Distanca (ne m) nga ku mund të perceptohet vibrimi |
|---------------------------|--|
| Germimet | 10-15 |
| Kompaktesimi, ngjeshja me | 10-15 |
| Kamionat e rëndë | 5- 10 |

Për shkak të afërsisë së objekteve të banimit e sherbimeve në afërsi nga vendi ku zbatohet projekti, ka mundësi që dridhjet nga implementimi i projektit të propozuar të jenë evidente. Të vetmet burime të vibrimit që të merret në konsideratë do të jenë kamionë të rëndë gjatë qarkullimit në objekt.

Energjia nga makinerite e ndërtimit transmetohet në tokë dhe shndërrohet në dridhje, të cilat zvogëlohen me distancë. Madhësia dhe dobësimi i dridhjeve në tokë varet nga:

- Efikasiteti i mekanizmit të transferimit të energjisë së pajisjeve (d.m.th impulsive; pajisjet kthyese, lëvizëse ose rrotulluese)
- Përmbajtja e frekuencës
- Lloji i valës (sipërfaqja ose trupi)
- Lloji i tokës dhe topografia.

Dridhjet e parashikuara të tokës në distanca të ndryshme për pajisjet tipike të ndërtimit janë paraqitur në Tabelën 11.

Tabela 11. Nivelet e parashikuara te vibrimit te pajisjeve te ndertimit (mm/s)

| Lloji i makinerise | Kriteret e preferuara te perceptimit njerezor | | Vibrimet e Parashikuara ne Toke | | | | |
|--------------------------|---|-------|---------------------------------|------|------|-------|-------|
| | Dite | Nate | 10 m | 30 m | 50 m | 100 m | 300 m |
| Pile driving (Impulsive) | 8.6 | 2.8 | 21.0 | 4.0 | 1.9 | 0.7 | 0.1 |
| | (17.0) | (5.6) | | | | | |
| Rrul (15 tonne) | 0.28 | 0.2 | 7.5 | 1.4 | 0.7 | 0.2 | <0.1 |
| | (0.56) | (0.4) | | | | | |
| Dozer | 0.28 | 0.2 | 3.3 | 0.6 | 0.3 | 0.1 | <0.1 |
| | (0.56) | (0.4) | | | | | |
| Ngjeshes (7 tonne) | 0.28 | 0.2 | 6.0 | 1.2 | 0.5 | 0.2 | <0.1 |
| | (0.56) | (0.4) | | | | | |
| Gure thyese | 0.28 | 0.2 | 7 | 1.3 | 0.6 | 0.2 | <0.1 |
| | (0.56) | (0.4) | | | | | |
| Fadrome | 0.28 | 0.2 | 1 | 0.2 | 0.1 | <0.1 | <0.1 |
| | (0.56) | (0.4) | | | | | |

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

Nisur nga fakti qe zona e projektit shtrihet brenda nje zone te banuar, eshte e nevojshme te ndermerren gjithë masat per te shmangur nivelet e larta te zhurmes; sikurse jane pershkruar ne vijim:

- i) Kontraktori do të jetë i kujdesshëm ne zgjedhjen e pajisjeve për të shmangur përdorimin e makinerive të vjetra apo të dëmtuara me nivel të lartë të emetim zhurme që do të kenë një ndikim negativ në mjedis.
- ii) Kontraktori do të sigurojë që pajisjet janë të mire-shërbyera dhe efikase.
- iii) Kontraktori do të bllokojë sheshin e ndërtimit me materiale që zbutin zhurmën, për shembull, përdorimi i kompensatës në vend të fletëve te llamarinave.
- iv) Punëtorët e ndërtimit do të jenë në dijeni të natyrës së ndjeshme të vendet të punës brenda të cilit ato operojnë dhe do këshillohen që të kufizojne zhurmën verbale ose format e tjera të zhurmës. Për shembull,

objektet apo mjetet metalike mund të kalojnë nga një koleg tek një tjetër koleg në vend që të hidhen poshte ose të lihen të bien me shumë zhurmë.

- v) Kontraktori do të sigurojë që nivelet e zhurmës që gjenerohen nga makinerite, automjetet dhe aktivitetet e zhurmshme të ndërtimit mbahet në nivele minimale për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e njerëzve në ndërtesat e afërta.
- vi) Zhurma dhe vibrimet në vendin e projektit dhe zonat përreth do të minimizohen nepermjet sensibilizimit të shoferëve të kamioneve të ndërtimit për të fikur motorët e automjeteve, gjatë shkarkimit të materialeve.
- vii) Gjeneratorët dhe pajisjet e rënda gjeneruese të zhurmave do të izoloohen ose të vendosen në rrethina për të minimizuar rritjen e zhurmës mbi nivelin e zakonshme të ambientit

5.1.8. Trafiku dhe emetimet që lidhen me te

Emetimet e lindura nga trafiku përfshijnë pluhurin dhe tymrat. Emetimet e pluhurit do të dalin nga aktivitetet e ndërtimit dhe trafiku i mjeteve të ndërtimit. Kamionët e përdorur për të transportuar materiale të ndryshme ndërtimi nga burimi i tyre për në sheshin e ndërtimit të objektit emetojnë gazra të ndryshme si SO₂, CO₂, CO, NO_x dhe grimca. Ndikimet e emetimeve të tilla mund të jenë më të mëdha në vendin e ndërtimit dhe në komunitetet ndërmjet të cilave do të udhëtojnë automjetet e ndërtimit. Receptorët e ndikimit përfshijnë komunitetet përgjatë rrugëve të transportit, dyqanet dhe tregjet anës rrugëve, punëtorët e ndërtimit.

Tabela 12. Faktorët e emetimit së makinerive të ndërtimit në cikle të ndryshme pune

| Lloji Makinerisë | Cikli i Punës | Factoret e Emetimit | | | | |
|------------------|----------------------------------|---------------------|-----------|------------------------|-----------|-------------------------|
| | | HC (g/hr) | CO (g/hr) | NO _x (g/hr) | PM (g/hr) | CO ₂ (kg/hr) |
| Bulldozer | Në sipërfaqe të ashpër | 130.09 | 270.01 | 806.53 | 5.56 | 55.13 |
| | Levizje materiali të grumbulluar | 100.53 | 272.45 | 962.29 | 8.78 | 83.44 |
| Kamione | Transport | 56.78 | 128.26 | 385.64 | 2.94 | 28.84 |
| Eskavator | Gërmim dheu | 126.94 | 341.57 | 1122.52 | 10.22 | 98.05 |
| Nivelues | Rrafshim i tokës | 75.52 | 200.45 | 655.43 | 5.86 | 56.48 |
| Gjithë pajisjet | Ndenjur ndezur | 18.34 | 36.00 | 105.96 | 0.67 | 6.72 |

Rëndësia e ndikimit:

| | | | Ndjeshmeria e receptorit | | | |
|------------------------|--------------|---|--------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| | | | Shumë e ulët 1 | E ulët 2 | Mesatare 3 | E lartë 4 |
| Intensiteti i ndikimit | Shumë e ulët | 1 | 1 I papërfillshëm | 2 I vogël | 3 I vogël | 4 I vogël |
| | E ulët | 2 | 2 I vogël | 4 I vogël | 6 I moderuar | 8 I moderuar |
| | Mesatare | 3 | 3 I vogël | 6 I moderuar | 9 I moderuar | 12 I madh |
| | E lartë | 4 | 4 I vogël | 8 I moderuar | 12 I madh | 16 I madh |

Në çdo rast, pavarësisht nga proceset që do të kryhen, cilësia e ajrit nuk do të çenohet jasht standarteve të parashikuara. Kësisoj, pritshmerite janë që cilësia e ajrit mund të çenohet më shumë gjatë proceseve të lëvizjes së kalldrëmit dhe gjatë zhvendosjes së mbeturinave të ndërtimit dhe dherave të dale nga gjermimi i trupit të rrugëve, sidomos nëse këto procese do të kryheshin në stinën e thatë të verës. Në literaturën teknike jepet vlera reference 0.15-0.30 kg/ m³ muaj për çlirimet e pluhurave që perhapen në mjedis. Këto çlirime mund të konsiderohen të pranueshme. Rikthimi i pluhurit në tokë, në fakt, supozohet se do të jetë shumë i vogël dhe do të ndodhë vetëm në zonën pranë sheshit të ndërtimit, kështu që nuk do të shkaktojë shqetësime mbetese për zonën rrethëqark.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Aktivitetet e ndërtimit do të kryhen gjatë ditës.
- ii) Do të mbahet nën kontroll shpejtësia e udhëtimit të automjeteve të ndërtimit;
- iii) Kamionet do të mbulohen gjatë transportimit të materialeve të ndërtimit;
- iv) Kurdo që është e nevojshme, zonat me pluhur dhe ato gjeneruese të pluhurit do të spërkatën apo lagon me ujë;
- v) Pajisjet e ndërtimit do të mbahen në gjendje të mirë operative për të reduktuar emetimet e gazrave;
- vi) Të gjitha makineritë para se të largohen nga sheshi, duhet të pastrojnë gomat e tyre në rast se ato janë të papastër;
- vii) Punëtorët do të pajisen me Pajisje Mbrojtëse Personale dhe do të zbatohet përdorimi i tyre.

- viii) Implementimi i projektit duhet të ndërmerret nga një kontraktor me përvojë dhe me një ndjenjë të verifikueshme ndërgjegjësimit dhe përgjegjësie mjedisore.
- ix) Zona e projektit do të jetë e rrethuar për të minimizuar migrimin e pluhurit për në objektet e afërta.

Tabela 13. Standartet e cilesise se ajrit dhe shkarkimet ndotese ne mjedis

| Autoriteti | Ndotësit | Vlerat mesatare të elementëve ndotës | | | | | | |
|----------------|----------|--------------------------------------|---|-----------------|--------------------------|---------------|--------|----------------------------------|
| | | SO ₂ | | | NO _x | | | |
| | | Vjetore | 24 h MAX | Ditore | Vjetore | 24 orë Max | Ditore | Orare |
| Banka Boterore | | 0.10 | 0.5 (jasht) | 1.0 (brenda) | 0.05 ppm | - | 0.05 | - |
| SHBA | | 0.02pp m[a] 0.03pp m[b] | 0.1ppm [a] 0.14ppm [b] 0.5ppm [ac] | - | 0.05 ppm | - | - | - |
| WHO | | - | 90µg/m ³ | - | - | - | - | 190- 320 µg/m ³ |
| UE | | 80 µg/m ³ | - | - | 200 µg/m ³ | - | - | - |

5.1.9. Siguria dhe shëndeti ne pune (OHS)

Aktivitetet e planifikuara në kuader të këtij projekti mund të paraqesin rreziqe pontenciale disa prej të cilave mund të jenë të rrezikshme për jetën. Puna me tension të lartë apo pune me nxehtësi (sikurse saldimit), përbëjnë një rrezik për dëmtime nga elektriciteti. Lëndime ose demtime të shtyllës kurrizore mund të ndodhin në qoftë se punëtorët mbajnë objekte të rënda. Rreziqe të tjera të mundshme mund të jenë: ndriçimi joadekuat ose nivel të kufizuar të shikimit gjatë fortunave duke krijuar vështirësi për stafin e makinerive të pajisjeve të rënda, makinave me sistem të papërshtatshëm frenimi, mungesë përqëndrimi ndërsa punohet dhe ekspozimin ndaj mbetjeve të rrezikshme të tilla si bojrat, çimento, adhezive dhe tretësit për pastrim. Kohëzgjatja e ndikimit do të jetë afatshkurtër pasi mund të ndodhi vetëm gjatë fazës së ndërtimit.

Udhëzimet e Bankës Botërore dhe legjislacioni Shqiptar kërkojnë që punëtorët e ekspozuar ndaj niveleve të zhurmës më të larta se 80 dB (A), për një

kohëzgjatje prej më shumë se 8 orë në ditë duhet të përdorin mbrojtëse për organet e degjimit.

Mundësia e ndodhjes së këtij ndikimi do të jetë e vogël duke pasur parasysh nivelin e sigurisë në sektorin e ndërtimit në Shqipëri dhe tipologjinë e nderhyrjeve të planifikuara.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i. Trajnimi i gjithë punëtorëve të ndërtimit lidhur me praktikat dhe udhëzimet për sigurinë në punë dhe kontrolli i vazhdueshëm që ata t'i përmbahen atyre.
- ii. Trajnimi do të kryhet si për të parandaluar ashtu dhe për të menaxhuar incidentet. Trajnimi duhet të përfshijë trajtimin e duhur lidhur me mënyrën se si të reagojnë kur ka probleme me energjinë elektrike, ujin, etj., dhe sensibilizimin për mënyrat e ndryshme të sjelljes dhe përgjegjësisë gjatë incidenteve të tilla.
- iii. Për të paralajmëruar stafin dhe / ose vizitorët që nuk janë të përfshirë në aktivitetet e ndërtimit lidhur me vendet e rrezikshme, duhet të përdoren tabelat sinjalizuese.
- iv. Mbikëqyrja e punimeve duhet të bëhet rregullisht për të siguruar që janë plotësuar kushtet e sigurisë, ndërsa çdo devijim nga rregullat e sigurisë duhet të përmiresohet menjëherë duke ndjekur praktikat më të mira në lidhje me sigurinë e pajisjeve të punës.
- v. Punëtorëve të ndërtimit duhet tu sigurohen Pajisje Personale Mbrojtëse.



Figura 24. Tabela sinjalizuese për punime ndërtimi

5.1.10. Aksidentet

Zona e projektit ndodhet në një pjesë mjaft të populluar të Përmetit ku zhvillohen nje sere aktivitetesh tregtare sidomos përgjatë rrugëve kryesore. Me rritjen e numrit te automjeteve të rënda gjatë transportimit të materialeve dhe pajisjeve te ndërtimit, do të kete rritje të rrezikut të aksidenteve apo lëndimeve të lidhura me trafikun. Aksidentet do të kene një ndikim i rëndësishëm social dhe veçanërisht ka te ngjarë të përfshijnë fëmijë, gra (të cilët zakonisht i kryqezojnë rrugët me ngadalë se meshkujt), njerëzit me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, pa harruar rreziqet qe mund të vijne nga renia poshte e materialeve apo mbeturinave nga aktivitetet e ndërtimit.

Renia e rrethimit apo skelave mund të shkaktojnë aksidente të dëmshme për jetën e njeriut.

Persa i perket kohëzgjatjes ky ndikim do të jetë afatshkurtër dhe do ndodhi vetëm gjatë fazës së zbatimit të projektit. Shtrirja e ndikimit do të jetë lokale. Gjasat qe ndikimi të ndodhi jane mesatare duke patur parasysh nivelin e ulët të sigurisë rrugore nga shoferët dhe këmbësorët në Shqipëri. Ndjeshmëria e receptorëve është E lartë pasi disa aksidente mund të çojnë në dëmtime të përhershme dhe të tjerë ne humbje të jetës, ndërsa intensiteti i ndikimit është i ulët. Prandaj rëndësia e ndikimit është e moderuar.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Kontraktori do të miratojë praktikak më të mira të sigurisë të transportit me qëllim parandalimin e aksidenteve në trafik dhe minimizimin e lëndimeve të pësuarra nga personeli i projektit dhe publiku, si më poshtë:
 - Kontraktori do të vëre theksin tek siguria nga ana e shoferëve. Në mënyrë të veçantë kontraktori do duhet të sigurohet qe shoferët të respektojnë kufijtë e shpejtësisë nëpër zonat me institucione publike;
 - Tabelat sinjalizuese lidhur me trafikun do të jetë te pozicionuara në kryqëzimet e rrugëve per ne qendrën spitalore për të kontrolluar shpejtësinë e levizjes se makinave;
- ii) Do të merren masa për kontrollin e trafikut përfshirë perdorimin e shenjave ne rrugë dhe personat me flamur qe paralajmërojnë KUSHTE TE RREZIKSHME dhe KALIM I FËMIJËVE.
- iii) Kontraktorët të kontrollojne rregullisht automjetet për të minimizuar aksidentet potencialisht të rënda si psh ato që shkaktohen nga mosfrenimi në kohën e duhur që ndodh me kamionët e mbingarkuar.
- iv) Sheshi i ndërtimit duhet të rrethohet dhe personeli i sigurisë duhet të ndalojë njerëzit e paautorizuar që të futen në objekt.
- v) Gjatë gjithë perimetrit të objektit duhet te vendosen shenja paralajmëruese.

- vi) Veshja e paisjeve mbrojtëse personale do të jetë kusht për punëtorët që janë në sheshin e ndertimit.

5.2. NDIKIMET GJATE FAZES SE FUNKSIONIMIT

5.2.1. Ndikimet Sociale

Rritja e numrit të turistëve dhe të ardhurave për komunitetin. Përmeti tërheq mijëra vizitorë në vit për shkak të natyrës së tij të bukur, trashëgimisë së tij kulturore dhe vendeve arkeologjike të njohura ndërkombëtarisht. Ky numër pritet të rritet me shpejtësi me zbatimin e projektit. Për më tepër, ai do të ketë potencialin për të integruar Ansamblin Historik në një rrjet më të gjerë të itinerareve turistike, duke përfshirë si pjesë të turizmit të trashëgimisë kulturore.

Mundësitë e punësimit: Rigjenerimi i lagjes së vjetër historike, Rehabilitimi i kanalit Perroi i Bardhë dhe Përmirësimi i sferës publike dhe hapësirave në qytetin modern do ta bëjnë zonën më tërheqëse për biznese të ndryshme, kryesisht shërbime. Këto do të krijojnë mundësi të tjera për punësim afatgjatë për profesionistë të ndryshëm, por edhe për punëtorë shumë të aftë, përfshirë gratë që mund të kthehen në traditën e punës artizanale, veçanërisht për produktet për turistët.

Masat për përmirësimin: Kudo që është e mundur, personat e kualifikuar vendorë do të konsiderohen për mundësi pune. Increased tourist numbers and their spending.

5.2.2. Përmirësimi i pamjes vizuale dhe rritja e vlerës së pasurisë së paluajtshme

Aktiviteti i propozuar do të ketë një ndikim të madh vizual në estetikën e zones së projektit duke e përmirësuar ndjeshëm atë.

Rigjenerimi i lagjes së Vjetër historike duke adresuar dhe nxjerrë në pah elementet historike dhe tradicionale të qytetit të Përmetit ku çdo shteg trajtohet si një "korridor i gjallë", dhe duke rivendosur të gjitha portat karakteristike prej druri; Rehabilitimi i kanalit "Perroi i Bardhë" me krijimin e një zone buferike përreth kanalit (parku linear), shndërrimi i zonës së hapur midis 2 urave si park urban dhe kopsht bujqësor urban; Përmirësimet në Qytetin Modern si psh krijimi i aksesit për këmbësorët në pjesën veriore të Përmetit dhe të Gurit të Qytetit, shtrirja e bulevardit përgjatë rrugës "Kongresi i Përmetit", realizimi i një korsie cikli për të rritur lëvizshmërinë e qëndrueshme dhe mbështetja e turizmit të çiklizmit në Leusa, Lëshicë dhe

destinacione të tjera përmes Përmetit, përmirësimi i ndriçimit publik dhe mobilimi urban, do ti japë një pamje tjetër të kësaj zone.

Përveç rritjes së interesit të turistëve vendas dhe të huaj, vlera e zonës do të rritet pasi cilesia e jetesës rritet dhe zona automatikisht kthehet në një atraksion shumë i rëndësishëm turistik.

5.2.3. Menaxhimi i papershtatshem i mbetjeve

Si rezultat i ndertimit, permiresimit apo rindertimit të hapësirave publike që do të frekuentohen nga turistë të shumtë vendas dhe të huaj, pritet të gjenerohen mbeturina të ndryshme. Këto mbetje do të jenë te parrezikshme, kryesisht të karakterit të mbeturinave shtëpiake. Grumbullimi, trajtimi dhe deponimi i papërshtatshëm i këtyre mbetjeve mund të shkaktojë rreziqe për shëndetin publik për shkak të ndotjes së mjedisit: ndotjes së ajrit, ndotjes së ujit dhe infeksioneve të ndryshme sidomos kur njerëzit kërkojnë mbeturina.

Rreziku i mundshëm nga mbeturinat e pakontrolluara është edhe ndotja bregut të Vjoses, pasi projekti zbatohet në një zonë që nuk ka distancë shumë të madhe nga rrjedha e Vjoses.

Ndikimi do të jetë afatgjatë dhe mund të zgjasë gjatë gjithë jetës së projektit. Intensiteti i ndikimit është i ulët nëse Bashkia dhe komuniteti marrin masat e nevojshme për adresimin e tyre. Ndjeshmëria ndaj receptorëve do të jetë e ulët, duke i dhënë ndikime minimale

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Bashkia do të sigurojë koshat e duhur të mbeturinave për llojet e ndryshme të mbeturinave të krijuara për të lejuar ndarjen dhe grumbullimin në pikën e gjenerimit.
- ii) Mbeturinat grumbullohen nga vendi i projektit të paktën një herë në 24 orë, në atë mënyrë që të minimizohen aromat dhe era e keqe, rrëmuja dhe pluhuri.
- iii) Komuniteti lokal do të trainohet ose edukohet mbi rëndësinë dhe mënyrat e administrimit dhe ndarjes së mbeturinave në shtëpi.

5.2.4. Gjenerimi i zhurmave

